



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË

### KUVENDI

*Komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin European”.*

### PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.11.2024, ora 09:30

### TRYEZË TEMATIKE PUBLIKE IV

**Drejton tryezën: Ina Xhepa**

#### **Rendi i ditës:**

Procesi i rregullt ligjor dhe edukimi ligjor i publikut.

#### **Marrin pjesë:**

Fatmir Xhafaj, Toni Gogu, Mimoza Arbri dhe Elda Zenelaj.

#### **Të ftuar:**

Nadia Rusi, Dorina Metalia, Alket Jaupi, Olta Aliaj, Ines Leskaj, Isabele Tomas Delic, Bjorka Duka, Nina Guga, Reald Keta, Ilva Hamzaj, Arjan Dyrnishi, Esida Bruçi, Alma Tandili, Blerina Celoaliaj, Elis Kuçi, Patricia Pogace, Lidja Lapi, Tedi Dobi, Elona Meço, Luan Veliqoti, Enkela Prifti, Linda Gjermani, Valbona Legisi, Ledjona Dalipaj, Klesta Hysi, Klodiana Vogli, Agnes Bernhard, Mauro Puzzo, Belina Bedini, Elga Mitre, Juelda Lamçe, Anila Hoxha,, Eliona Llaja, Etleva Hoxha, Piro Lutaj, Armer Juka, Rudina Brari, Anesti Kapllani, Romina Kostani, Nadia Guni, Viktor Mërkuri, Gilda Hoxha, Fiona Tako, Klara Kodra, Besa Velaj, Anila Shehi, Leonard Busho, Endri Teta, Nevila Gjata, Drita Shkurti, Zilie Feci, Nadire Pilavi, Greta Nurcelli, Ador Koleka, Anairda Arizaj, Orieta Çobani, Oltjon Dano, Enea Rrapaj, Hasim Keci, Gabriela Çallo, Anisa Lezi, Blertina Cenaj, Marsida Sulaj, Sabrina Çallëku dhe Isela Hunçi.

## HAPET MBEDHJA

**Ina Xhepa** – Zotërinj deputetë,

Të nderuar ekspertë,

Kolegë të shoqërisë civile,

Përfaqësues të institucioneve kushtetuese dhe ligjore,

Ju falënderoj që jeni sot pjesë e tryezës së parë të diskutimit për sa i përket nënkapitullit të mbrojtës së të drejtave themelore, brenda kapitullit të madh të sundimit të ligjit, në kuadër të analizës, që komisioni i posaçëm parlamentar “Për thellimin e reformave për mirëqeverisjen, sundimin e ligjit dhe antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Europian” ka hartuar tashmë prej disa muajsh!

Në tryezën e sotme, sikurse jeni njohur edhe nga dokumentet e shpërndara me kujdes nga stafi mbështetës i Kuvendit, nga sekretariati i këtij komisioni të posaçëm, do të ndalemi në dy elemente kryesore, që janë mjaft të rëndësishme për funksionimin dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, natyrisht edhe në Europë dhe më gjerë.

Së pari, do të ndaj me ju gjetjet e analizës së kryer gjatë këtyre muajve për sa i përket të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si një ndër të drejtat bazë në një kuadër kushtetues dhe ligjor, që aspirojnë të integrohet në BE.

Pas diskutimit për gjetjet e analizës dhe, natyrisht, nevojat për ndërhyrje dhe sugjerimet që do të marrim sot nga ju për sa i përket të drejtës për një proces të rregullt ligjor, do të vazhdojmë me pjesën e dytë të kësaj tryeze, ku kolegja ime, zonja Olta Aliaj, komisionere për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve pranë institucionit të Avokatit të Popullit, do të moderojë, pikërisht, komponentin e edukimit ligjor të publikut, i cili vlerësohet nga ky komision si element kryesor për funksionimin, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri.

Qëllimi i tryezës së sotme është që diskutimi ynë të jetë sa më konciz dhe i shkurtër, në mënyrë që të mbledhim sa më shumë opinionet dhe mendimet tuaja për sa u përket tezave për diskutim.

Unë e bëra si parantezë, juristët dhe teknologjia nuk shkojnë shumë mirë, por do të kalojmë çdolloj eventualiteti teknik me mbështetjen e kolegëve.

E drejta për një proces të rregullt ligjor përfshin, natyrisht, një sërë elementesh të së drejtës, siç janë: pavarësia, paanësia e gjyqësorit, gjykatat e krijuara me ligj, aspektet procedurale të së drejtës së një individi, që ndodhet në duart e shtetit, siç mund të jetë e drejta për të pasur një avokat, e drejta për t'u siguruar që personi i arrestuar të kuptojë gjuhën në të cilën i flitet dhe, më e rëndësishmja, prezumimi i pafajësisë, aksesit real në drejtësi, përfundimi i procesit brenda një afati të arsyeshëm, dhe e fundit, por jo më pak e rëndësishme, ekzekutimi i vendimeve gjyqësore përfundimtare. Natyrisht, të gjithë këta elemente nuk mund të shihen të ndarë nga njëri-tjetri dhe nuk mund të funksionojnë të ndarë nga njëri-tjetri.

Në kuadër të kësaj analize, ne do të donim të ndanim me ju (natyrisht besoj se të gjitha arritjet e reformës në drejtësi kanë bërë të mundur ristrukturimin tërësor të sistemit gjyqësor, veçanërisht për sa i përket qeverisjes së gjyqësorit) që jemi njohur në referencat e të gjitha raporteve ndërkombëtare dhe në analizën e sotme do të donim të ndaleshim te sfidat me të cilat është ndeshur reforma dhe zbatimi i saj, por edhe të gjitha ligjet që janë amenduar, pra ligjet e ashtuquajtura paketa e reformës.

Së pari, për sa u përket sfidave, ne kemi evidentuar ato sfida që lidhen me aksesin në drejtësi, e drejtë themelore kjo për çdo qytetar, një pjesë e të cilave mund të vijnë dhe janë duke derivuar nga riformatimi i hartës gjyqësore në Republikën e Shqipërisë.

Një aspekt tjetër, me të cilin aksesit në drejtësi ndikohet drejtpërdrejt, është konsolidimi i funksionimit të ndihmës juridike falas, shërbim i cili ofrohet nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas. Ky shërbim është konsoliduar dhe ka funksionuar gjatë këtyre viteve, megjithatë, ka ende nevoja për përmirësimin e këtij shërbimi.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm është respektimi i afatit të arsyeshëm. Natyrisht, postulati i çdo studenti drejtësie, por edhe i çdo profesionisti të së drejtës është: “Drejtësia e vonuar, është drejtësi e mohuar”, dhe përfundimi i çështjeve brenda një afati të arsyeshëm ligjor vjen si një problematikë e evidentuar nga kjo analizë, ku evidentohet dhe nënvizohet pjesa e vakancave në sistemin gjyqësor, të cilat janë krijuar nga procesi i vetingut, por edhe nga një sërë arsyesh të tjera, si dhe mungesa e sistemeve mbështetëse, siç mund të jenë sistemet teknologjike të menaxhimit të rasteve, mosfunksionimi i skemës së delegimit e të tjerë.

Për sa i përket aspektit procedural, të cilin e përmendëm edhe në krye të herës, që është mjaft i rëndësishëm lidhur me drejtën për një proces të rregullt ligjor, është pikërisht prezumimi i

pafajësisë, çdo person prezumohet i pafajshëm derisa ndaj tij merret një vendim i formës së prerë që vërteton të kundërtën.

Nga raportet e partnerëve ndërkombëtarë, por edhe nga analiza e kryer gjatë këtyre muajve nga grupi i punës së komisionit të posaçëm, është vërejtur nevoja për një përafrim legjislacioni me standardet e BE-së, që lidhet pikërisht me paraburgimin e zgjatur të të gjithë personave që ndalohen dhe arrestohen, por edhe me deklaratat publike, që bëhen ndaj këtyre personave, duke i shpallur të fajshëm përpara se ndaj tyre të merret një vendim përfundimtar nga një gjykatë. Në fakt, prezumimi i pafajësisë dhe problematikat që lidhen me prezumimin e pafajësisë janë evidentuar disa herë me radhë në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut në çështjet kundër Shqipërisë, ne mund të kujtojmë çështjet: “Caka kundër Shqipërisë” ose “Groni kundër Shqipërisë”, ku respektivisht paraburgimi është konsideruar i pajustificuar, ose masa është cilësuar joproporcionale.

Një element tjetër i evidentuar, si një sfidë gjatë analizës së bërë për sa i përket të drejtës për një proces të rregullt ligjor, është edhe mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore është vërejtur si në aspektin e vendimeve të gjykatave vendase, ashtu edhe për sa u përket vendimeve të marra nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut. Në fakt, askujt nuk i intereson një vendim gjyqësor, qoftë ky edhe në favor të personit, në rast se ky vendim mbetet vetëm në letër dhe nuk ekzekutohet nga organet përkatëse.

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore është vërejtur si një problem edhe nga Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut, ku përmendim se Shqipëria ka ende më shumë se 40% të çështjeve, të cilat nuk janë ekzekutuar. Në vendimin *quasi* pilot “Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë”, i marrë në vitin 2014, gjykata ka evidentuar ndërmarrjen e masave të brendshme për të rregulluar këtë problem sistematik të strukturës sonë.

Për sa u përket tezave për diskutim, grupi i ekspertëve ka evidentuar disa nevoja për ndërhyrje, për të cilat më pas do të donim të merrnim opinionin tuaj.

Së pari, për sa i përket aksesit në drejtësi, është vërejtur se mirëfunksionimi skemës së ndihmës juridike, por edhe elemente të tjera që garantojnë aksesin, do të funksionojnë me buxhete të konsoliduara, të cilat mbështesin këtë lloj shërbimi. Këto buxhete nuk do të mbështeten vetëm me asistencën e partnerëve ndërkombëtarë, që për sa i përket ndihmës juridike kanë qenë mjaft të qenësishme, natyrisht edhe për aspekte të tjera të reformës dhe funksionimit të shtetit të së drejtës.

Gjithashtu, është evidentuar nevoja për lehtësim procedurash për grupet vulnerabël, pasi ne e dimë që ndihma juridike është një shërbim, që merret nga personat që nuk kanë mundësi financiare për të aksesuar një shërbim ligjor profesional, por, nga ana tjetër, për të gjithë personat, të cilat kategorizohen si grupe të paavantazuara. Gjithashtu, vërehet nevoja për zgjerimin e kategorive, që ligjet shikojmë me prioritet kategori të veçanta, siç mund të jenë viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.

Për sa i përket përfundimit të çështjeve gjyqësore brenda një afati të arsyeshëm, është vërejtur me domosdoshmëri, besoj se nuk jemi të parët që e themi, plotësimi i vakancave në sistemin gjyqësor, krijimi i një infrastrukture të përshtatshme, veçanërisht për sa i përket teknologjisë së informacionit, e cila do të lehtësojë menaxhimin e çështjeve gjyqësore dhe krijimin e një *software*-i të qëndrueshëm, i cili do të aksesohet nga çdo nivel i gjyqësorit.

Fokus i veçantë duhet të vendoset te promovimi i gjyqtarëve brenda sistemit, në bazë të parimit të meritokracisë, i cili aplikohet dhe duhet të vazhdojë të aplikohet nga institucionet e qeverisjes së sistemit gjyqësor; riaktivizimi i skemës së delegimit të gjyqtarëve brenda sistemit; shtimi i numrit të ndihmesave, veçanërisht në gjykatat e Apelit, sepse, qoftë Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, qoftë Gjykata e Apelit e Juridiksionit Administrativ të Posaçëm, kanë një mbingarkesë shumë të madhe, ku, përveçse kanë mungesë gjyqtarësh, kanë edhe një numër shumë të madh të dosjeve të mbartura.

Për sa i përket të drejtës së prezumimit të pafajësisë, është vërejtur përafrimi i legjislacionit me standardet europiane dhe me direktivën e posaçme të BE-së, por edhe rritje e vazhdueshme e kapaciteteve në të gjitha instancat shtetërore që merren me çështjet penale, veçanërisht të oficerëve të Policisë Gjyqësore, prokurorëve e me radhë. Natyrisht, një pjesë të madhe të kësaj rritjeje kapacitetesh e mbulon edhe Shkolla e Magjistraturës, por duhet të vazhdojë të jetë e qëndrueshme.

Për sa i përket ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, për të pasur një të drejtë efektive në vend për secilin qytetar, është vërejtur si nevojë rishikimi i legjislacionit për ekzekutimin e vendimeve vendase, por edhe për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, ku mund të krijohet edhe një sistem i posaçëm monitorimi në të dyja rastet. Natyrisht, institucionet shtetërore, përfshirë edhe Avokaturën e Shtetit, kanë përgjegjësi funksionale dhe ligjore që i zbatojnë, por, duke vërejtur numrin e çështjeve të paekzekutuara dhe *backlog*-un, veçanërisht në ekzekutimin e vendimeve vendase për sa i përket sistemit përmbarimor shtetëror, vërehet një nevojë për një ndërhyrje lidhur me ekzekutimin.

Unë ju premtova që sfidat, natyrisht edhe përmbledhja e nevojave për ndërhyrje, që ne kemi bërë gjatë kësaj pune disamujore, do të ishte shumë e shkurtër, ndaj në këtë moment do të doja që të nisnim diskutimin për sa u takon 5 tezave modeste që ne kemi vërejtur, që janë me vlerë për t'u diskutuar dhe për të marrë mendimet tuaja në këtë tryezë.

Së pari, kemi evidentuar një tezë, që ka të bëjë me ndikimin e riformatimit të hartës së re gjyqësore dhe aksesit faktik që qytetarët kanë në gjykatat e shkallëve të para dhe ato të apelit, veçanërisht në zonat rurale, ku këto gjykata mungojnë.

Së dyti, do të doja të diskutonim së bashku se si mund të përmirësohet ofrimi i ndihmës juridike falas për qytetarët në nevojë, pas ndryshimeve që ka sjellë harta e re gjyqësore, si dhe nëse duhet të ekzistojë një plan për zbutjen e risqeve, që lidhen me zvogëlimin e numrit të gjykatave dhe përmirësimin e infrastrukturës digjitale për sistemin gjyqësor.

Gjithashtu, do të doja të diskutonim së bashku dhe të merrnim vlerësimin tuaj se cilat janë pengesat kryesore, që ndikojnë në përfundimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm për sa u përket proceseve gjyqësore në të gjitha nivelet në gjykatat vendase.

E fundit, por jo nga rëndësia, është edhe një tezë, që lidhet me nevojën, nëse do ta konsiderojmë të tillë, të një ligji të veçantë për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut apo do të mjaftohemi vetëm me ndryshimet që janë bërë dhe që mund t'i bëhen në vijim ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Avokaturës së Shtetit në Republikën e Shqipërisë”.

Duke u ndalur këtu, unë do të doja t'ju ftoja në diskutim për të dëgjuar me shumë kujdes opinionet tuaja për sa u përket këtyre tezave, që lidhen me funksionimin në praktikë të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Secila ndërhyrje duhet të jetë 3 deri në 5 minuta, me qëllim që t'i lejojmë të gjithë kolegët që dëshirojnë të shprehin mendimet e tyre.

Faleminderit!

**Ilva Hamzaj** – Përsëndetje!

Unë jam Ilva Hamzaj, kandidate për gjyqtare, viti i tretë, nga Shkolla e Magjistraturës.

Fillimisht dua të theksoj shkurt rolin e Shkollës së Magjistraturës, tejet thelbësor në plotësimin e vakancave të sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë për shkak të procesit të vetingut. Nga eksperiencia ime, besoj dhe vlerësoj se Shkolla e Magjistraturës ka pasur angazhimin maksimal për të plotësuar vakancat jo vetëm në kriterin sasior, por edhe në atë cilësor, duke përgatitur magjistratë për të dalë në detyrë, të cilët disponojnë jo vetëm aftësitë juridike dhe

profesionale, por edhe aftësitë e posaçme, që i nevojiten një gjyqtari, të ashtuquajturat *soft skill*-sa, të cilat, ndonëse në pamje të parë duken si dytësore, për sa i përket rëndësisë në raport me formimin profesional, janë shumë të rëndësishme për të krijuar akses te qytetarët. GJEDNJ-ja vënë gjithmonë theksin që aksesin në drejtësi nuk quhet të jetë formal, por aksesin duhet të jetë substancial. Aksesin substancial nënkupton të drejtën e çdo qytetari që i qaset sistemit të drejtësisë lidhur me një problematikë të tillë, për të pasur mikpritjen dhe shqyrtimin e problematikës së tij në themel.

Lidhur me aksesin substancial, për ta lidhur jo vetëm me ndihmën ligjore falas në gjykimet civile dhe administrative, por edhe me mbrojtësit e caktuar, kryesisht në proceset penale, nga eksperiencia ime gjatë stazhit profesional, por edhe eksperiencave të mëparshme, vë re se ende lë për të dëshiruar cilësia e përfaqësimit të avokatëve kryesisht. Pra, avokati nuk duhet të caktohet vetëm për të qenë në proces për sa i përket procedurës, por duhet të jetë i aftë të studiojë dosjen dhe të japë mbrojtjen më të mirë. Këtu mund të jap si shembull ngritjen e padive me bazë ligjore të gabuar, që përbëjnë pastaj shkak për rrëzimin e tyre, gjë të cilën e kam hasur disa herë në gjykatat civile dhe administrative. Gjithashtu, kemi rastin kur bëhen kërkesa procedurale të pabazuara ose në rastin e gjykimeve penale, ku i pandehuri nuk njihet nga avokati, kryesisht për të drejtat e tij procedurale, për të paraqitur kërkesa lidhur me provat apo meritat e posaçme të gjykimit, të cilat, nëse nuk ngrihen në një fazë të caktuar, mund të humbin, duke cenuar kështu aksesin në thelbin e tij.

Kështu që, mendoj se një ndër pikat që duhet të merret në konsideratë është trajnimi i mëtejshëm i avokatëve, sidomos pasja e një sistemi monitorimi për mbrojtësit e caktuar, kryesisht dhe avokatët, të cilët ofrojnë ndihmën ligjore falas.

Për sa i takon hartës gjyqësore, është e vërtetë që është rritur distanca për zonat rurale për të aksesuar gjykatat. Për zonat rurale ky problem ka ekzistuar edhe më përpara hartës së re gjyqësore, pasi, në qoftë se vjen nga një provincë apo një zonë rurale shumë e thellë, gjithsesi ,nevojitet udhëtimi për të mbërritur në gjykatë. Ajo që vërehet në praktikë, flas për proceset civile dhe administrative, është se padia të depozitohet nëpërmjet shërbimit postar, por paralelisht nuk është e mundur që taksa gjyqësore të paguhet nëpërmjet një sistemi *online*, pasi duhet marrë fillimisht dëshmia financiare nga zyrat e financës së gjykatës. Kështu që, në qoftë se do të ishte e mundur që në këtë sistem menaxhimi gjyqësor të çështjeve, të cilën ju propozuat, të integrohet një mundësi aksesin për qytetarët, në mënyrë që ata të parapaguajnë taksën gjyqësore bazë për paditë e

tyre, kjo do ta ndihmonte aksesin dhe do të hiqte detyrimin për t'u paraqitur në gjykatë përpara zhvillimit të një seance.

Gjithashtu, me ndryshmet procedurale që ka pësuar Kodi i Procedurës Civile në 2021-in, ashtu edhe Kodi i Procedurës Penale në 2017-ën, është shtuar mundësia për të zhvilluar gjykime me videokonferencë, por vihet re që në praktikë për këto gjykime, edhe për shkak të mungesës së sistemit videokonferencë në çdo sallë gjyqësore, nuk është e përdorshme në nivelin, që të anticipohet nga ligjvënësi në prezantimin e këtij mjeti ligjor. Kështu që, mendoj se kjo çështje duhet zgjidhur nga pikëpamja infrastrukturore, së pari, dhe, së dyti, nëpërmjet ndërgjegjësimit edhe të qytetarëve, edhe të avokatëve, që zhvillimi i seancës nëpërmjet videokonferencës nuk do të thotë cedim në zhvillimin e procesit, në gëzimin e atyre të drejtave procedurale dhe ligjore që ata gëzojnë dhe do të ndikojë në përfundimin e një procesi më të shpejtë dhe në uljen e kostove për qytetarin, se në fund të ditës aksesin nënkupton që ta realizosh të drejtën tënde me kostot më të ulëta të mundshme.

Për sa i takon *backlog*-ut, që vërehet në çdo gjykatë, ndoshta më pak te seksioni penal për shkak të afateve të ngutshme, mendoj se prezenca e ndihmësve do të ishte shumë e nevojshme. Unë mendoj se ka ardhur momenti, të paktën përkohësisht, që të shikohet mundësia që ndihmësit të vendosen edhe pranë gjykatave të shkallëve të para. Pra, të vendoset një numër i caktuar, pasi realisht ngarkesa që ka Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, me rreth 900 dosje për gjyqtar, është e pamundur për t'u realizuar objektivisht ose së paku është shumë e vështirë për t'u realizuar objektivisht dhënia e një drejtësie cilësore, dhënia e një vendimi shterues, që të analizojë të gjitha pretendimet e palëve.

Gjithsesi, gjej me vend të them se Shkolla e Magjistraturës është përpjekur të ofrojë trajnim vazhdues jo vetëm me gjyqtarët dhe prokurorët, por edhe me aktorë të tjerë të sistemit të drejtësisë, i cili ka në fokusin e tij edhe menaxhimin e çështjeve, edhe menaxhimin e kohës gjyqësore, edhe afatet për zbardhjen e vendimeve, duke përfshirë, përveç gjyqtarëve, prokurorëve dhe kandidatëve, edhe aktorë të tjerë të tjerë të këtij sistemi: nga ILD-ja, oficerë të Policisë Gjyqësore, ndihmësit dhe këshilltarët ligjorë në Gjykatën e Lartë. Ndoshta mund të shihet mundësia për zhvillimin e trajnimeve tematike, duke identifikuar paraprakisht këto problematika që has sistemi gjyqësor, për të parë ndoshta edhe studime praktike, në mënyrë që të gjenden zgjidhje më relevante.

Lidhur me prezumimin e pafajësisë, vlerësoj se, siç është rekomanduar, prezumimi i pafajësisë në ato raste në të cilat është cenuar, duhet të implikojë një shpërblim të drejtë për të

pandehurin. Në rastin konkret shikojmë që shpërblimi për burgim të padrejtë vazhdon të qëndrojë i pandryshuar ndër vite, në masën maksimale 5 mijë lekë për çdo ditë burgim të padrejtë. Mendoj se kjo vlerë tashmë nuk reflekton ndryshimet financiare që ka pësuar shoqëria shqiptare, nuk reflekton normën e inflacionit dhe mbetet, gjithsesi, shumë e ulët në raport me normën që është e aplikueshme në vendet e tjera. Kështu që, për t'iu përshtatur më mirë realitetit ku ne jetojmë, për t'iu përshtatur atij qëndrimi dhe asaj brenge, që vuan një person i burgosur në mënyrë të padrejtë, kjo masë mund të reflektohet, për t'iu përshtatur edhe inflacionit që ka pësuar Shqipëria ndër vite.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Shumë faleminderit për ndërhyrjen në lidhje me monitorimin e funksionimit të cilësisë së ndihmës juridike falas si në aspektin penal, administrativ dhe civil; për elementet që dhatë për zgjidhje për sa i përket uljes së kostove dhe aksesit efektiv në drejtësi të qytetarëve të prekur nga ndryshimet e hartës së re gjyqësore; për ndërhyrjet që mund të bëjë Shkolla e Magjistraturës, por edhe institucionet e tjera të sistemit; për zgjidhjen e vakancave; për shtimin e numrit të ndihmesave në gjykatat e shkallës së parë; për zgjidhjen e *backlock*-ut, por edhe për reflektimin e ndryshimeve për të reflektuar realitetin për sa u përket personave të burgosur në mënyrë të padrejtë, ndryshime që besoj se vijnë edhe në referencë të standardeve europiane!

**Patricia Pogaçe** – Përshëndetje!

Jam Patricia Pogaçe, përfaqësuese e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Me miratimin e hartës së re gjyqësore, një ndër fokuset kryesore të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas ka qenë hapja e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ambientet e gjykatave, tashmë të mbyllura si pasojë e riorganizimit të skemës. Qëllimi ka qenë që këto qendra të shërbejnë si një urë lidhëse për qytetarët në nevojë, të cilët në shumicën e rasteve nuk kanë mundësi ekonomike për t'i përballur edhe shpenzimet e udhëtimit, midis këtyre qendrave dhe gjykatave të hapura. Aktualisht ne disponojmë qendra në ish-gjykatën e Matit, të Kurbinit, të Kavajës, të Tropojës, të Përmetit, duke u dhënë kështu një mundësi më tepër shërbimi dhe garantim aksesit për individët në nevojë.

Aktualisht, drejtorja administron 20 qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe nga viti në vit kemi mundësuar kalimin e këtyre qendrave, si pjesë e buxhetit të shtetit, të cilat më parë kanë qenë të hapura me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, përmendim këtu UNDP-në, si në ndër partnerët kryesorë të institucionit.

Risi është që për vitin 2025 në parim është miratuar që në strukturën e Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas do të kalojnë të gjitha qendrat, pra të 20 qendrat, duke garantuar në këtë mënyrë mbulimin dhe administrimin e tyre në mënyrë tërësore nga ana e institucionit. Siç e përmendët, qëllimi dhe fokusi i ligjit për ndihmën juridike është ofrimi i një shërbimi gjithëpërfshirës, jo vetëm për personat në pamundësi ekonomike, por edhe për kategori të veçanta. Aktualisht, ligji mundëson mbulimin e 12 kategorive të veçanta, përfshirë këtu personat me aftësi të kufizuar, viktimat e dhunës në familje, të miturit në konflikt me ligjin, personat që janë përfitues nga skemat e mbrojtjes sociale. Pa dyshim, nevojat janë ende më gjithëpërfshirëse, përmendim këtu kategoritë rome dhe egjiptiane, të cilët janë evidentuar si kategori që të domosdoshme në përfshirjen e skemës së ndihmës juridike, si persona vulnerabil, drejtpërdrejt përfitues. Pra, pavarësisht kostos ekonomike, ata duhet të jenë përfitues në mënyrë të drejtpërdrejtë, për t'i ndihmuar në këtë mënyrë edhe në lehtësimin e procedurës, pra për ta bërë procedurën më pak burokratike, por edhe për t'u mundësuar shërbim parësor dhe dytësor në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Pra, siç e përmendëm, një nga gjetjet e raportit është fakti se tashmë është bërë i mundur konsolidimi i skemës, duke mos pasur të domosdoshme nevojat për mbështetje nga partnerët ndërkombëtarë. Pa dyshim, nevojat për mbështetje vijnë dhe ekzistojnë, por tashmë fokusi ynë ka kaluar jo në 20 qendrat, që janë të hapura, por në bashkitë më të vogla, ku edhe informacioni për shërbimin ligjor falas ka ende mundësi për përmirësim.

Një ndër propozimet tona, që u është përcjellë edhe partnerëve ndërkombëtarë, ka të bëjë me hapjen e disa qendrave apo disa pikave të referimit, ku të mundësohet dhënia e këtij informacioni apo dhënia e shërbimit edhe në bashkitë e vogla në Shqipëri.

U përmend gjatë fjalimit të përfaqësueses së Shkollës së Magjistraturës që nevojitet një trajnim më i mirë i avokatëve ofrues të shërbimit të ndihmës juridike dytësore. Me anë të partnerëve tanë, si OSBE-ja, ne kemi bërë të mundur që ofruesit e ndihmës juridike parësore të trajnohen, sidomos për mënyrën e komunikimit dhe qasjes që ata duhet të kenë ndaj kategorive vulnerabil, si: viktimat e dhunës apo të miturit.

Ndërsa për sa i përket skemës së ndihmës juridike dytësore, më duhet të theksoj se ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike dytësore, pra avokatët tanë, që janë pjesë e listës së ndihmës juridike, janë të ndryshëm nga avokatët kryesisht.

Avokatët, që janë pjesë e listës sonë, në mënyrë që të marrin pagesën për shërbimin e ofruar, duhet të kalojnë në disa hallka monitorimi, nga ana e një drejtorie të dedikuar të

monitorimit, që është brenda Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas. Pra, bëhet i mundur verifikimi i cilësisë së shërbimit dhe më pas vijohet me kryerjen e pagesave, duke bërë të mundur që shërbimi për qytetarët, përveçse të jetë falas, duhet të jetë edhe cilësor. Përveç shërbimeve të ndihmës juridike parësore dytësore, nga ana e institucionit, në kuadër të garantimit të aksesit tërësor në drejtësi, mundësohet edhe pjesa e parapagimit nga shpenzimet gjyqësore, si dhe për të gjitha shpenzimet që mund të dalin gjatë procesit gjyqësor, siç janë shpenzimet për ekspertë, psikologë, topografë, që janë të nevojshëm gjatë procesit gjyqësor.

Nëse më lejoni, dua të bëj një parantezë. Në vitin 2023 kemi 7008 raste me ndihmë juridike parësore dhe 773 vendime juridike dytësore, pra kemi përfaqësim ligjor falas për individët në nevojë. Ndërsa për periudhën janar – shtator 2024 kemi 4755 raste për ndihmë juridike parësore dhe 599 vendime juridike për ndihmë juridike dytësore.

Për pjesën e nevojave, nevoja më e madhe që kemi evidentuar, tashmë që kapacitetet i kemi të konsoliduara, ka të bëjë me informimin. Informimi i qytetarëve në rajonet më të vogla është një ndër sfidat që kemi hasur dhe për këtë është e nevojshme të ketë një bashkëpunim më të lartë ndërinstitutional. Sidomos me institucionet vendore dhe me mekanizmat e referimit në bashki, për të bërë të mundur evidentimin e rasteve dhe drejtimin e tyre pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Ju falënderoj për ndërhyrjen tuaj, duke evidentuar masat e marra nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, por edhe për evidentimin e problematikave, të cilat janë reflektuar edhe në analizën e zgjeruar që ky komision ka hartuar, duke u ndalur edhe në zgjerimin e kategorive, sikurse e përmendëm edhe më lart.

Këto prioritete do të elaburohen edhe nga kolegja ime, zonja Nadia Rusi, në pjesën e dytë, por problematikë mbetet informimi i qytetarëve dhe vajtja e mesazhit të ofrimit të këtyre shërbimeve që mundësojnë aksesin real të qytetarëve në drejtësi, të personave që vërtetë kanë nevojë.

Po, fjala për ju.

**Oltion Dano** – Quhem Oltion Dano, jam përfaqësues i SEE-së, si dhe partner pranë zyrës ligjore KALO & Associates. Gjithashtu, jam pjesë e këtij komponenti të këtij komisioni, ku kemi diskutuar edhe me kolegët lidhur me gjetjet që u prezantuan nga kolegja Xhepa, për sundimin e ligjit.

Përgjithësisht ndër problemet që u diskutuan, dua të them që për hartën e re gjyqësore duhet të ketë përmirësim të anës logjistike. Po marrim rastin e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, për të cilën mund të adresohet apo të mendohet për një ambient të ri, se ambienti aktual është i pamjaftueshëm. Organika e kësaj gjykate përbëhet nga 78 gjyqtarë, nga të cilët aktualisht kemi rreth 24 apo 25 gjyqtarë, ndërsa salla janë rreth 11, nëse nuk gaboje dhe janë rreth 24 apo 25 zyra. Pra, efektivisht, sikur të plotësohet organika, këta gjyqtarë nuk mund ta ushtrojnë funksionin e tyre, ndaj kërkohet një ndërhyrje. Kuptohet duhet menduar se si mund të jetë zgjidhja, mund të shikohet një ambient i posaçëm, mund të ndahen përkohësisht në 2 dhoma, në penale dhe civile, që të paktën të ketë mundësi të punohet në këtë drejtim.

Një element tjetër që dua ta shtoj për diskutim, është puna shumë e mirë që është bërë nga Ministria e Drejtësisë për miratimin, pas shumë kërkesave, mbi 10 vjet, e ligjit “Për arbitrazhin”. Gjithashtu, është ndërmarrë edhe një fushatë për njohjen dhe bërjen me dije të gjithë komunitetit që mund ta përdorin arbitrazhin si një mënyrë alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Ky është një moment shumë i mirë, në kushtet kur gjykatat janë të mbingarkuara, që të vendoset theksi te mënyrat alternative për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, qofshin këto arbitrazh.

Për sa i përket pjesës së ndërmjetësisimit, ndërmjetësimi, gjithashtu, është një proces që është shumë i dobishëm, sepse të dyja palët arrijnë një marrëveshje dhe asnjëra nuk del e humbur dhe në fund të ditës marrin një titull ekzekutiv. Si mënyrë alternative përdoret shumë pak dhe përgjithësisht në të drejtën familjare.

Gjithashtu, arbitrazhi është shumë i rëndësishëm për të drejtën tregtare. Të gjithë besoj se i dimë përfitimet që sjell arbitrazhi në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke pasur vetëm një shkallë gjykim përbën urdhër ekzekutimi dhe është shumë i shpejtë në raport me gjykatat e posaçme.

Të gjitha elementet që u diskutuan për sa i përket *backlog*-ut, të cilat u nxorën nga Shkolla e Magjistraturës së gjyqtarëve të rinj, si emërimi nga shkallët e para, promovimi i gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit, mendojmë se do të shkojmë drejt përmirësimit të situatës, por kjo do të kërkojë pjesën e saj.

Një komponent tjetër i rëndësishëm, që e kemi diskutuar në tryezë, është sundimi i ligjit dhe procesi i rregullt ligjor që përfshin anën administrative të saj, pra të shikohet jo vetëm ana gjyqësore, por edhe ajo pararendëse e saj. Pra, ka vend të përmirësohen dhe të shikohen ato dispozita që parashikon Kodi i Procedurës, në sensin e implementimit, sesa në sensin e rishikimit, sepse Kodi i Procedurës Administrative i reflekton të gjitha. Pra, të shikohen vonesat, të shikohet

përgjigjja dhe raporti që ka administrata publike në raport me afatet e posaçme, kthimet e përgjigjeve dhe përgjegjësitë në dhënien e përgjigjeve të tyre.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Shumë faleminderit, zoti Dano, për ndërhyrjen tuaj mbi zgjidhjet e mundshme për sa i preket funksionimit të hartës së re gjyqësore dhe problematikave që ka sjellë, edhe nga pikëpamja strukturore, veçanërisht për Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe për evidentim, sjelljen në vëmendje dhe promovimit të zgjidhjes alternative të mosmarrëveshjeve, pasi vonesat e ardhura nga *backlog*-u gjyqësor sjellin pasoja (në rastin më të mirë sjellin pasoja financiare).

Pra, të gjitha subjektet e së drejtës që i drejtohen gjykatës duhet ta konsiderojnë edhe formën alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Meqenëse e kemi kuadrin ligjor, pse të mos promovohet te qytetarët, në mënyrë që ata të mos kenë besim vetëm te gjykata, por edhe te mënyrat e shpejta të zgjidhjes së konflikteve juridike? Gjithashtu, edhe për sa i përket rishikimit të implementimit të dispozitave të Kodit të Procedurës Administrative, veçanërisht duke u ndalur te respektimi apo jo i afateve nga institucionet e administratës publike në nivel qendror dhe vendor.

Po, fjala për ju.

**Fiona Tako** – Përshëndetje, quhem Fiona Tako, përfaqësuese e fushës akademike, por njëkohësisht edhe të asaj të avokatisë.

Në fakt, dua të trajtoj dhe të sugjeroj disa çështje konkrete.

Së pari, për sa i përket afatit të rëndësishëm të seancave gjyqësore dhe problematikës së madhe të tejzgjatjes së proceseve gjyqësore, për mendimin tim, sidomos në fushën civile, ato kanë të bëjnë me pamundësinë e realizimit të njoftimeve mes palëve, që burojnë si pasojë e vështirësisë së identifikimit të adresave.

Mund të gjendet ndoshta mundësia që rezultatet e censusit të zhvilluar të mund të përkthehen në një formë të caktuar si akses nga gjykata, por edhe nga palët, me qëllim identifikimi e adresave të sakta të palëve për realizimin e njoftimeve. Ka raste ku seanca të tëra gjyqësore shkojnë dëm, pikërisht për këtë shkak, për mosrealizimin e njoftimit të palëve.

Problemi i dytë, për mendimin tim, që u trajtua edhe nga përfaqësuesja e Shkollës së Magjistraturës, ka të bëjë me realizimin e seancave *online*. Situata Covid 19, që e përjetuam të gjithë, solli në pah rëndësinë e madhe të shfrytëzimit të mjeteve teknologjike me qëllim realizimin e çdo pune që kishim, por edhe të seancave gjyqësore. E shikoj si problem dhe si një zgjidhje të

mundshme shumë të rëndësishme në realizimin e seancave, sidomos për çështje familjare ku kemi të bëjnë me zgjidhje martesë. Dihet që në këto lloje seancash, seanca e parë ka si qëllim pajtimin, pra realizimin e mundësisë së pajtimit mes palëve dhe kjo seancë mund të bëhet nëpërmjet seancave *online*.

Një problem tjetër të rëndësishëm e shikoj edhe në rastin, jo thjesht të vështirësisë në ekzekutimin e vendimit, por në mosekzekutimin në tërësi të vendimeve gjyqësore në rastet e detyrimeve apo konflikteve mes shoqërive tregtare, ndaj mendoj që mund të jetë një mjet i rëndësishëm i shtimit të kontrollit mbi shoqëritë tregtare forcimi i rolit të institucioneve të posaçme, siç është Qendra Kombëtare e Biznesit, sepse shpeshherë shoqëritë janë në pamundësi për të shlyer detyrimet e tyre apo për të ekzekutuar një vendim gjyqësor pikërisht për shkak të kapitalit që e kanë deklaruar dhe të pandryshuar për vite me radhë.

Këto janë tri problematikat që mendoj se mund të marrin një zgjidhje konkrete nëpërmjet këtyre mënyrave.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Faleminderit për ndërhyrjen për sa i përket respektimit të afatit të arsyeshëm dhe konsolidimit të sistemit të adresave në Republikën e Shqipërisë, problem sistematik ky në gjithë këto dekada, gjithashtu edhe në promovimin e seancave *online*! Besoj se një pjesë e madhe e kolegëve e mbajnë mend që edhe në momentet e prezantimit të regjistrimit gjyqësor audio-video u hasën pengesa, të cilat më pas u kaluan nga sistemi dhe nga ndërgjegjësimi i të gjithë aktorëve që bëjnë pjesë në këtë sistem.

Gjithashtu, ju falënderoj për ndërhyrjen tuaj në forcimin e rolit të institucionit të posaçëm, siç mund të jetë Qendra Kombëtare e Biznesit, për sa i përket ekzekutimit të konflikteve me karakter tregtar mes shoqërive tregtare.

Fjalën e ka zonja Anila Hoxha. Ndërsa më pas kolegu.

**Anila Hoxha** – Jam Anila Hoxha, gazetare për çështjet e drejtësisë dhe së paku në 25 vjetët e fundit kam raportuar për të gjitha sfidat e drejtësisë shqiptare. Vitin e fundit, kemi një emision *podcast*, dedikuar drejtësisë shqiptare, në “Top Albania Radio”, ku raportuam dhe trajtuam në mënyrë të thelluar të gjitha sfidat e drejtësisë shqiptare përmes qendrës “Fol”.

Më lejoni të rendis disa problematika nga investigimi i stafit të qendrës “Fol”, të cilat i kemi transmetuar. Do ta nis me *backlog*-un e çështjeve në drejtësinë shqiptare. Në një nga episodet trajtuam odisenë e të moshuarve që presin në gjykatat civile, të apelit dhe ato administrative për

sa i takon çështjes së pensioneve dhe zyrtarisht u informuam se 6500 të moshuar vazhdojnë të presin drejtësinë shqiptare për çështjen e pensioneve për vitet e humbura dhe proceset me Institutin e Sigurimeve.

Unë do të flas me emra shtetasish. Njëri prej tyre quhet Kujtim Braha nga Krraba, i cili pas 5 vjetësh pritjeje ndërroi jetë dhe nuk mori drejtësi. Kishte një proces për vitet që kishte humbur, por për shkak të *backlog*-ut procesi u shty vazhdimisht, por edhe për shkak të disa shkarkimeve nga procesi i vetingut gjyqtarët e kaluan çështjen e tij stafetë.

Zaide Peca nga Burreli. Çështja e saj për pensionin u gjykua në Gjykatën e Apelit të Tiranës dhe pas një pingpongu të gjatë ajo pati fatin e mirë që, në fund të një procesi të tejzgjatur, megjithëse në tejkalim të afateve të arsyeshme, ta fitojë procesin.

Mustafa Kokshi është 70 vjeç dhe vazhdon gjyqin në shkallën e parë të Gjykatës Civile të Tiranës, një ish-punonjës në ish-kombinatin “Josif Pashko”, të cilit i kanë humbur vitet e punës dhe vazhdon të presë.

Problematika që kam parë në Gjykatën e Apelit Admirativ, që duhet theksuar dhe nuk mund ta harroj, por që është pranuar zyrtarisht nga KLGJ-ja për shkak të një investigimi që po kryej për edicionin e lajmeve, është se *backlog*-u dhe stoku i çështjeve në gjykatat shqiptare ka përfunduar në mbi 140 mijë dosje. Në gjendjen më të rëndë, në këtë epikrizë, vazhdon të jetë Gjykata e Apelit të Tiranës dhe Gjykata e Apelit Administrativ. Ata që presin në këto dy gjykata vazhdojnë të kërkojnë përshpejtim të procesit, madje edhe në kërkesat për përshpejtim procesi është krijuar *backlog*.

Ju e dini që Gjykata Kushtetuese është shprehur në disa raste për procese të tejzgjatura, por edhe për çështjen e pronave.

Shkojmë te pronat. Në episodin e transmetuar në “Top Albania” për sa u përket pronave, konstatuam se 637 shtetas shqiptarë kanë rënë pre e atentateve nga viti 1998 për shkak të konflikteve për pronat.

185 shtetas shqiptarë janë vrarë për shkak të konflikteve me njëri-tjetrin për tokat dhe për proceset nga vitit 1998. Këto janë të dhëna zyrtare të pranuar nga policia shqiptare.

Zyrtarisht pranohet se 12 mijë shtetas shqiptarë presin në gjykatat shqiptare, sepse kanë konflikte me njëri –tjetrin për çështjen e pronave.

Pranohet se janë 2000 çështje në pritje në Gjykatën e Lartë, përsëri për konflikt pronash. Kjo për sa i takon *backlog*-ut.

E dyta, lidhet me çështjen e transparencës. Ju e dini që në kuadër të reformës në drejtësi hyri një figurë e re që është gjyqtari i medias dhe prokurori i medias. Pavarësisht trajnimeve të tyre, përpjekjeve të tyre dhe gjithë dëshirës për të qenë sa më transparent dhe të ndihmojnë median, mendoj që gjyqtarët dhe prokurorët në Shqipëri nuk janë ende të ndërgjegjësuar për të kuptuar rolin e medias, por edhe të publikut në kuadër të transparencës, përfshirë këtu edhe standardet se si duhet të ndiqet një proces gjyqësor. Kur flas për standardin, se këto i kanë garantuar ndryshimet ligjore, nuk mund të vazhdojmë ende me ngërçe të natyrës, të shpjegojmë vazhdimisht në dyert e gjykatës se përse duhet të ndjekin një proces gjyqësor. Cilat janë arsyet? Gjyqet që janë të hapura, pa përfshirë ato që ndalohen, publiku dhe media duhet të lejohen, pa dhënë shpjegime se cilat janë arsyet që ata duhet ta ndjekin këtë proces gjyqësor.

Problemi tjetër është zbardhja e vendimeve gjyqësore, pavarësisht se kemi deklarata të natyrës: për shkak të mungesës së stafit, për shkak të ngarkesës, ruajtja e të dhënave personale, por zbardhja e vendimeve ndihmon transparencën. Ka edhe shumë probleme të tjera për sa i takon ndihmës ligjore falas, por u prekën nga parafolësit ndaj nuk dua të marr kohën e të tjerëve që duan të flasin.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Faleminderit, zonja Hoxha, për ndërhyrjen tuaj, për sa i përket vëmendjes që duhet të kenë grupet e caktuara shoqërore, siç janë pensionistët apo grupet e tjera, që nuk duhet konsiderohen si kolateral i reformës në drejtësi, për shkak të vakancave në sistem, ndërhyrjes suaj për sa i përket transparencës gjyqësore. Në fakt, sistemi gjyqësor është mësuar të ketë qenë i mbyllur dhe besoj se do kohën e tij për qasjen dhe promovimin e transparencës, pavarësisht se tashmë i kemi të gjithë ata që i quajmë *press judge*, si dhe zbardhjen e vendimeve gjyqësore dhe bërjen të mundur për publikun, duke anonimizuar ato raste që parashikohen nga ligji për t'u anonimizuar dhe për të ruajtur të dhënat personale, praktikë shumë e konsoliduar edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, jurisprudencë dhe standarde që i qasim në sistemin tonë ligjor.

Vlen të theksohet dhe prioritarizimi i çështjeve, krijimi i një strategjie të detajuar për prioritarizimin e çështjeve, për sa i përket konflikteve pronësore, unë nuk dua të ndalem, sepse është një tryezë e posaçme në të cilën do të diskutohen të gjitha problematikat dhe mënyrat potenciale të zgjidhjes për sa i përket konflikteve gjyqësore.

Faleminderit!

Po, fjala për ju

**Pirro Lutaj** – Përsëritje të gjithëve!

Quhem Pirro Lutaj, jam drejtori i Përgjithshëm i Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror, strukturë në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Në fakt, kam disa vite që e drejtoj atë shërbim dhe kjo është ndër tavolinat e pakta që në mënyrë eksplicite është përmendur drejtësia dhe roli që duhet të ketë Shërbimi i Përmbarimit.

Dua t'ju them shkurtimisht dy fjalë. Prej dy vjetësh Shërbimi Përmbarimor Shtetëror ka një fizionomi të re, kjo falë ligjit të ri të miratuar në shkurt të vitit 2023, ky ligj nuk ishte ndryshuar prej vitit 2001. Pra, janë bërë akte të reja në zbatim të tij dhe aktualisht veprojmë në bazë të hartës së vjetër gjyqësore, por ligji i ri përcakton organizimin tjetër në bazë të hartës së re gjyqësore, por jo vetëm. Ajo që dua të them këtu është një raport shumë i zhdrejtë që kemi mes çështjeve që administrojmë dhe numrit të kufizuar të përmbaruesve. Është një shifër mjaft shqetësuese dhe po ta dëgjoni, do të thoni që paskemi një shërbim formal dhe me probleme sidomos për sa u përket afateve.

Ne kemi gjithsej rreth 75 përmbarues të shpërndarë në të gjithë territorin e Shqipërisë, ndërkohë që administrojmë rreth 55 mijë çështje të karaktereve të ndryshme. Ne jemi në proces të ristrukturimit të shërbimit, sigurisht nën kujdesin e ministrit të Drejtësisë, kemi përcaktuar nevojat imediate të shërbimit, pra pas miratimit të ligjit dhe akteve nënligjore është shumë e rëndësishme vendosja e shërbimit në bazë të një strukture dinjitoze. Unë nuk di nëse ndonjëri në këtë sallë i ka parë ambientet e shërbimit përmbarimor, por ato janë ambiente të pakonsiderueshme, ndaj janë kthyer në një shqetësim shumë të madh. Nëse ndonjëri e ka parë me sytë e tij, mund ta thotë këtë gjë. Pra, është shumë i rëndësishëm rishikimi i sistemimit.

Bashkë me ministrin e Drejtësisë po shikojmë vendosjen e disa zyrave në gjykatat që janë suprimuar dhe kanë lëvizur, por nuk besoj se do ta realizojmë të vendosemi në ish-gjykatat.

Tjetër problem është shtimi i përmbaruesve. Edhe për këtë problem kemi bërë një studim që ia kemi paraqitur ministrit, duke vendosur një raport të drejtë mes ngarkesës së çështjeve në ekzekutiv dhe numrit të përmbaruesve, që të mos dalim jashtë logjikës së afateve. Këtu u përmendën domosdoshmëria e afatit të realizimit të një ekzekutimi, se në fund të fundit një proces i rregullt ligjor konsiderohet i tillë nëse ai ekzekutohet, nëse ngelet në sirtarët tanë, për arsye që sapo i thash, do të thotë që ne nuk e kemi bërë si duhet punën.

U mundova të them këtu një angazhim të posaçëm për shërbimin në këta dy vjetët e fundit, përpjekjet që po bën Ministria e Drejtësisë për ta sistemuar me gjithë kapacitetet e veta, por këto 2-3 gjëra të vogla janë realisht në tavolinën e ministrit të Drejtësisë.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Faleminderit për sjelljen në vëmendje të problematikave reale, me të cilat ndeshet sistemi Përmbartimor Gjyqësor Shtetëror, në lidhje me raportin e zhdrejtë të numrit të dosjeve dhe numrit të përmbartuesve dhe për nevojën e një infrastrukture dinjitoze, për të kryer këtë aspekt procedural të procesit të rregullt ligjor, i cili është i domosdoshëm për të pasur një drejtësi efektive!

Fjala për zonjën Leskaj.

**Ines Leskaj** – Faleminderit, Ina!

Dua të kërkoj ndjesë nëse i rikthehem edhe një herë çështjes që u përmend nga kolegja nga Shkolla e Magjistraturës, lidhur me ndikimin e hartës gjyqësore në qasjen e qytetarëve dhe veçanërisht të grupeve në nevojë. Ne si organizata të grave, kemi reaguar sapo u paraqit harta e re gjyqësore, jo që të ndalonim procesin, nuk ishte ky qëllimi ynë, por që të vendosnim në vëmendje çështjet e këtyre sfidave që po përmenden, për vajzat dhe gratë që mund të jenë viktimat të dhunës me bazë gjinore, por dhe të viktimave të dhunës në familje, duke përfshirë edhe fëmijët e tyre.

Që ta bëj më konkrete, një viktimë e dhunës në familje, shpeshherë viktimë e dhunës ekstreme, të cilës i rrezikohet edhe jeta, për shembull, nga Puka, i duhet të shkojë në gjykatën e Shkodrës. Cili institucion i mbulon shpenzimet e tij? Pra, përveç rasteve që janë të limituara, që mbështeten nga organizatat e shoqërisë civile, të cilat kanë fonde dhe burime të limituara, nuk ka një institucion që paguan shpenzimet e udhëtimit të tyre, procedurat gjyqësore e të tjera. Kjo është pothuajse e pamundur, për shkak të mentalitetit, për shkak të kontekstit jo vetëm të zonës, por të gjitha zonave, të vogla apo të mëdha qofshin, ndaj kjo detyron viktimën që të kthehet në atë rrethin vicioz, t'i rikthehet asaj shtate të tmerrshme të dhunës dhe të mos largohet nga dhuna.

Edhe një herë dua të theksoj faktin që ne mbështesim procesin e reformave dhe hartën e re gjyqësore, por ne e dinim që do të kishte efekte kolaterale te qytetarët sidomos te grupet vulnerabël dhe këto efekte do të duhet të ishin menduar, duke parashikuar burimet për marrjen e masave reale, për mbështetjen e këtyre qytetarëve dhe qasjen e tyre në aksesin në drejtësi.

Thënë këtë, duhet theksuar, meqenëse jemi mbledhur për çështje që i takojnë edukimit ligjor të publikut, të paktën në ato zona ku ne punojmë nga Veriu në Jug në të gjitha bashkitë e

vendit, sidomos në zonat më të vogla, se lë shumë për të dëshiruar çështja e informimit ligjor. Shumë e shumë nga rastet që kemi mbështetur nuk janë të informuar për ndihmën juridike falas.

Duhet theksuar edhe fakti që proceset penale që mund të ndjekin zyrat përkatëse të ndihmës juridike falas janë përsëri të limituara. Ne flasim për procese penale dhe këto raste kanë nevojë që t'u ofrohet edhe sigurimi i jetës, sepse kemi të bëjmë me raste që u rrezikohet jeta. E e di që kalova në përsëritje, por dua të ritheksoj edhe një herë nevojën e reagimit dhe marrjes së masave me burime konkrete.

**Ina Xhepa** – Faleminderit, zonja Leskaj, për sjelljen në vëmendje të ndikimit të hartës së re gjyqësore, për trajtimin e fatit të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, problem sistematik dhe gangrenë e shoqërisë sonë! Natyrisht edhe për përfshirjen e një mase konkrete në planin që mund të bëhet në zbutjen e efekteve të hartës së re gjyqësore, për sa i përket shpenzimeve konkrete financiare që hasin viktimat e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, për të aksesuar gjykatën. Në analizën e zgjeruar të komponenti i procesit të rregullt ne kemi evidentuar edhe tejzgjatjen e afateve edhe për masat e sigurimit që duhet të jenë çështje që mbarojnë menjëherë dhe brenda gjithë afateve procedurale, problematikë që evidentohet dhe vjen si pasojë e mungesës së gjyqtarëve në sistem, por edhe për probleme të ardhura nga mosinformimi ligjor i qytetarëve, probleme të cilat kolegja, zonja Rusi, do t'i elaburojë në pjesën e dytë të këtij takimi.

Kemi edhe një ndërhyrje tjetër.

Po, fjala për ju.

**Blerina Çeloaliaj** – Quhem Blerina Çeloaliaj dhe vij nga shoqata “*Save the children*”. Në kuadrin e vijimit të diskutimeve nga shoqëria civile për kategoritë në nevojë, mendoj që ia vlen të bëjmë një apel për kategorinë e fëmijëve që janë në konflikt me ligjin.

Nuk e di nëse ka qenë subjekt i disa prej pyetjeve që mund të ketë ngritur studimi juaj për të kuptuar se sa efektive është drejtësia në marrjen e vendimeve në interesin më të mirë të fëmijëve, por gjëja tjetër që ne e shohim me shqetësim është se sa efektive është drejtësia jonë në uljen recidivizmit, pra rasteve përsëritëse. Ne e kuptojmë nga qasja jonë që kjo nuk është një çështje dhe problematikë vetëm e drejtësisë, e cila adresohet vetëm me masa juridike, apo nëpërmjet ndihmës ligjore falas, apo nëpërmjet disa masave të tjera që kanë qenë një progres i mirë tashmë, por kërkon edhe një zgjidhje multisektoriale edhe ndër-institucionale.

Gjëja që vëmë re se mungon është vëmendja e shtuar përkundrejt riintegrit, por edhe parandalimit. Ndoshta nga disa pyetje që mund të bëhen më vonë ne duhet të mendojmë së bashku për disa zgjidhje më afatgjata dhe jo momentale. E ngre si çështje për të kuptuar nëse ka qenë pjesë e analizës suaj apo do të jetë në vëmendjen tuaj, përkundrejt reformës së re, hartës së re, por edhe përkundrejt mënyrës se si janë të vendosura shërbimet tona, të cilat vijnë në ndihmë të drejtësisë qoftë për parandalim, qoftë për adresim, por sidomos për riintegrim dhe ulje të recidivizmit.

Faleminderit.

**Ina Xhepa** – Ju falënderoj, zonja Çeloaliaj, për sjelljen në vëmendje të një kategorie mjaft të rëndësishme siç janë fëmijët! Natyrisht nevojat dhe problematikat për marrjen e shërbimit nga kjo kategori janë analizuar në dokumentin analitik të përgatitur nga komisioni i posaçëm. Pra, jo vetëm në rastin e fëmijëve, por në të gjitha problematikat e evidentuara është theksuar dhe nënvizuar nevoja e qasjeve ndërsektoriale, pasi të drejtat e njeriut, për natyrën e tyre, nuk mund të garantohen dhe të respektohen vetëm nga një institucion, por nga një zinxhir të tërë institucional.

Gjej rastin t’ia jap fjalën koleges, Komisioneres pranë Avokatit të Popullit për të drejtat e Fëmijëve, zonjës Olta Aliaj.

**Olta Aliaj** – Faleminderit, Ina!

Unë dua t’i kthehem pak pjesës së përfundimit të çështjeve brenda afatit të arsyeshëm, me fokus pak edhe çështjet e fëmijëve.

Ne këtë vit kemi bërë një studim, një kërkim, më saktë një draftaport, pikërisht për sa i përket përfundimit të çështjeve të fëmijëve brenda afatit të arsyeshëm, sepse kemi identifikuar që ka një zvarritje në gjykata për sa u përket këtyre çështjeve, pavarësisht se ka një vendim të KLGJ-së, ku thuhet se çështjet e fëmijëve kanë prioritet dhe duhet të shikohen me prioritet për sa u përket afateve nga ana e gjyqtarëve, por na ka rezultuar se gjyqtarët kanë tendencën që t’i gjykojnë çështjet sipas datës së ardhjes, jo sipas objektit dhe personave që ndikohen apo afektohen nga objekti i padisë. Nga ky studim kemi nxjerrë një gjetje, që dua ta veçoj pak, për sa i përket sistemit të brendshëm të menaxhimit të çështjeve në gjykata, i cili na rezulton që nuk është i harmonizuar në të gjitha gjykatat, pra nuk është i unifikuar. Kjo krijon problematika, sidomos për gjenerimin e statistikave dhe për komunikimin midis gjykatave, sepse për *back log*-un e dimë që është shumë i rëndësishëm gjenerimi nga vetë sistemi i statistikave, për shembull, cilat janë çështjet e fëmijëve, ndarja e gjinisë djem- vajza, kohëzgjatja. Pra, të gjitha këto janë elemente, pra statistikave, që

ndihmojnë jo vetëm KLGJ-në, por edhe vetë gjykatat, për menaxhimin e brendshëm dhe për shpejtimin e çështjeve, sidomos për sa u përket grupeve vulnerabël dhe specifiku të fëmijëve.

Për sa i përket *backlog*-ut në gjykata në përgjithësi, besoj se sistemi që ka adoptuar Gjykata e Lartë, ka dhënë rezultate pozitive, pra marrja e ndihmesave nga jashtë gjykatës për t'i evaduar sa më shpejt çështjet. Besoj se si një lloj mase apo si një lloj zgjidhje kjo mund të adaptohet edhe në Gjykatën e Apelit.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Faleminderit për sjelljen në vëmendje të nevojës së prioritizimit të çështjeve, në bazë të tematikës dhe objektit të tyre, një strategji dhe një praktikë e mirë, e cila mund të huazohet edhe nga reforma e ndodhur në Gjykatën Europiane për të Drejtat e Njeriut, gjykatë, e cila ka vendosur kryefjalë prioritizimin e çështjes dhe zgjidhjen e çështjeve prioritare në fillim, gjithashtu, edhe për risjelljen në vëmendje të mungesës së sistemeve të menaxhimit të çështjeve, që nuk sjellin vetëm vonesa në proces, por edhe mungesë të statistikave, veçanërisht për sa i përket target grupit të fëmijëve.

**Valbona Legisi** – Faleminderit!

Unë jam Valbona Legisi nga Avokatura e Shtetit.

Dua të ndalem tek tema e ngritur për diskutim: a është i nevojshëm një ligj i veçantë për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ-së, apo mjaftojnë ndryshimet në ligjin “Për Avokaturën e Shtetit”. Atëherë, në vlerësimin tonë, nuk ka nevojë për një ligj të ri, pasi në ndryshimet, që pësoi ligji “Për Avokaturën e Shtetit” në fund të vitit 2018, u parashikua qartë e gjithë procedura që do të ndiqet për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë të Gjykatës së të Drejtave të Njeriut. Në parashikimet e këtij ligji janë të parashikuara afatet, të gjitha veprimet që kryhen që nga momenti kur vendimi merr formë të prerë, duke përfshirë këtu dërgimin e vendimit për përkthim në Ministrinë e Drejtësisë, publikimin e tij në Fletoren Zyrtare, certifikimin e tij, më pas parashikon të gjithë procedurën që ndjek Avokatura e Shtetit për përcjelljen e këtij vendimi të gjitha organeve për njohje, kryesisht gjykatave, për njësim të praktikës gjyqësore. Më pas Avokatura e Shtetit harton edhe projektvendimin, të cilin e paraqet për miratim në Këshillin e Ministrave, dhe në këtë projektvendim janë të përcaktuara afatet, mënyra e ekzekutimit, organet përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë, deri në finalizimin e të gjithë procedurës. Me miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave, i cili ka afatet kur duhet të miratohet, publikohet vendimi dhe, me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, atëherë dihet që ai vendim duhet të zbatohet dhe Avokatura e Shtetit që nga momenti

i hyrjes në fuqi të VKM-së e monitoron këtë proces. Në rastet kur ka ndonjë vështirësi objektive, pa diskutim që pranohet, në raste të tjera parashtrohen në Këshillin e Ministrave të gjitha problematikat, duke identifikuar edhe organet përgjegjëse, të cilat bëhen pengesë për ekzekutimin e këtij vendimi. Kështu që, për sa kohë janë të përcaktuara në ligj, në vlerësimin tonë, nuk ka nevojë për një ligj të ri, nuk ka ndodhur që të mos zbatohet një vendim i Gjykatës së të Drejtave të Njeriut, sepse nuk ka një parashikim ligjor ku ta identifikojë, ku ta dërgojë vendimin për zbatim, pra nuk kemi pengesa të kësaj natyre. Kështu që, vlerësojmë se ndryshimet, që pësoi ligji në fund të vitit 2018, i kanë dhënë zgjidhje edhe ekzekutimit të formës së prerë të vendimeve të GJDNJ-së. Kështu, që në vlerësimin tonë, janë të mjaftueshme dhe mjafton ai ligj.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Ju falënderoj për paraqitjen e pozicionit tuaj institucional, nëse mund ta themi kështu, në lidhje me nevojën ose jo për miratimin e një ligji të posaçëm për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut. Në fakt, analiza është ndalur në evidentimin e problematikave për sa u përket monitorimit të këtij ekzekutimi, përcaktimit të përgjegjësive të qarta institucionale, pavarësisht ndryshimeve të vitit 2018, krijimit të një fondi të dedikuar kompensimi në buxhetin e shtetit, i cili nuk do të preket nga ndryshimet eventuale të buxhetit faktik drejt fundit të vitit dhe rritje të transparencës së institucionit të Avokaturës së Shtetit për sa i përket ekzekutimit të çështjeve të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, por edhe një koordinim më i mirë ndërinstitutional, pasi përgjegjësia e ekzekutimit nuk ngelet vetëm detyrë e një institucioni, por e një zinxhiri të tërë.

Zoti Dobi.

Faleminderit!

**Tedi Dobi** – Përsëndetje!

Jam Tedi Dobi, zëvendësministër i Drejtësisë.

Së pari, shumë faleminderit për kontributet e shumëfishta! Ishte vërtet interesante për të dëgjuar disa nga problematikat kryesore. Patjetër, janë problematika, të cilat të gjithë i kemi hasur dhe tashmë ka ardhur faza që të gjendet adresimi i duhur i tyre.

Gjithashtu, ne jemi në fazat e finalizimit të strategjisë ndërsektoriale të drejtësisë, ku një sërë prej këtyre problematikave kanë gjetur vend dhe trajtim, por sa më shumë që t'i diskutojmë dhe të shikojmë nga aktorë të ndryshëm problematikat, si ato vijnë, aq më mirë është, në mënyrë që t'i adresojmë sipas funksioneve institucionale që të gjithë kemi.

Kam dy-tri çështje kryesore që unë doja të prekja, duke qenë se disa nga institucionet e varësisë tashmë kanë folur, qoftë përmbartimi, qoftë ndihma juridike janë shprehur edhe për situatën që ndodhemi.

Në lidhje me disa çështje kryesore të ngritura, për *backlog*-un të gjithë jemi dëshmitarë të faktit që kemi ende problematikë *backlog*-un, ku patjetër që lajmi pozitiv është se Gjykata e Lartë ka pasur një rënie të *backlog*-ut, pra nga rreth 37 mijë çështje tani janë rreth 26 mijë çështje, pra ka treguar se një qasje proaktive është e aftë të sjellë ulje të *backlog*-ut, por në gjykatat e tjera kemi një numër të madh. Për shembull, Gjykata e Apelit Tiranë, në mos gaboj, me 57 mijë çështje, nëse nuk gaboj, ka numrin më të madh.

Një nga elementet kryesore që të gjithë biem dakord se do të jetë shumë i rëndësishëm, është edhe ngritja e sistemit të ri të integruar të menaxhimit të çështjeve, ku kam kënaqësinë të konfirmoj se tashmë janë bërë të gjitha dokumentacionet përkatëse për ndërveprimin e të gjitha sistemeve dhe janë vendosur në dispozicion edhe zërat buxhetorë për financimin e këtij sistemi të integruar, ku, duke filluar nga viti 2025, gjykatat nëpërmjet KLGJ-së dhe prokuroritë nëpërmjet Prokurorisë së Përgjithshme do të jenë të afta që të fillojnë ndërtimin e këtij sistemi, i cili parashikohet që të marrë rreth 5 vjet, ku 3 vjetët e parë janë ndërtimi i tij nga ana teknike, në fund të vitit të tretë fillon edhe popullimi me të dhëna, ku bëhet në çdo moment i përdorshëm gjatë gjithë kohës. Një element ndërveprimi që është rënë dakord, është edhe pjesa e ndërveprimit midis sistemeve të “e-Albania”-s, për shembull, sistemit elektronik të gjendjes civile, ku tashmë ka edhe një legjislacion të ri për adresarin dhe përmirësimin e tij, që të sigurojë ndërveprimin e të dhënave, apo edhe ndërveprimi i të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë për marrjen e statistikave. Pra, realisht do të jetë një instrument shumë i rëndësishëm dhe kemi arritur atë etapën e rëndësishme, ku buxheti i shtetit financon pjesën më të madhe për gjyqësorin.

Gjithashtu, kemi një marrëveshje financimi me suedezët për pjesën e mbetur të gjyqësorit, ndërkohë për pjesën e prokurorisë UNOPS-i, i kontraktuar nga Bashkimi Europian, është duke bërë financimin përkatës. Pra, është një element i vënë në vijë, dhe tashmë do të dojë edhe kohën e tij fizike për teknikët që të bëjnë punën përkatëse, si dhe elemente të tjera.

Elementi i dytë shumë i rëndësishëm që u diskutua, është infrastruktura. Në këtë drejtim, kemi vënë në dispozicion zërat e nevojshëm buxhetorë për KLGJ-në dhe jemi në diskutime për to për identifikimin e tokës së nevojshme dhe marrjen e masave të tjera për ndërtimin e godinës së re të Gjykatës së Apelit.

Gjithashtu, po shikojmë edhe për disa zgjidhje më afatmesme, sepse patjetër, si puna e sistemit, këto gjëra kërkojnë kohë të ndërtohen dhe, në të njëjtën kohë, jemi në bashkëpunim shumë të ngushtë me KLGJ-në për gjetjen e zgjidhjeve alternative, të cilat plotësojnë totalisht të gjitha nevojat që ato kanë. Për elementin e recidivizmit, që u trajtua edhe për të miturit, ne pranë ministrisë si institucion varësie kemi Qendrën e Parandalimit Krimit të Fëmijëve në Konflikt me Ligjin. Një element i rëndësishëm i punës që ka bërë qendra, përtej përditshmërisë së saj, ka qenë edhe finalizimi i të gjithë procesit për ndërtimin e Institutit të ri për Integrimin e të Miturve në Konflikt me Ligjin, i cili vjen me një qasje moderne, duke marrë për bazë edhe modelin francez dhe standardet e *brown house-it*, në mënyrë që të kemi një instrument më tepër në luftën kundër krimit, sidomos krimit në moshë të re dhe minimizimit të recidivizmit. Pra, këto janë disa nga tematikat kryesore, por ka ende shumë elemente të rëndësishme, të cilat duhen diskutuar, ku edhe tema tjetër që do të diskutojmë, “Edukimi ligjor i publikut” është shumë i rëndësishëm, sepse me të drejtë edhe përfaqësuesja e nga komuniteti i mbrojtjes së viktimave e tha që ka instrumente, por ndoshta nuk njihen mjaftueshëm sa duhet. Pra, edhe në pjesën tjetër besoj se do të kemi disa informacione dhe ndarje eksperiencash me vlerë.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Faleminderit, zoti Dobi, për sjelljen në vëmendje të hapave që po merr Ministria e Drejtësisë për sa u përket aspekteve problematike që u diskutuan gjatë kësaj tryeze!

Një ndërhyrje e fundit, para mbylljes së pjesës së parë të këtij takimi, nga zoti Jaupi, Gjykata e Lartë dhe më pas përmbyllim pjesën e parë për sa i përket të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe jemi konform agjendës për të nisur pjesën e dytë të edukimit të ligjor.

**Alket Jaupi** – Faleminderit, Ina!

Përshëndetje të gjithëve!

Unë doja të sillja në vëmendje një element, ndoshta pak aksesor për diskutimin që po zhvillojmë, por i rëndësishëm në kuptimin shkak-pasojë të të gjithë diskutimit që po bëjmë në kuadër të procesit të rregullt gjyqësor.

E drejta për proces të rregullt ligjor, si e drejtë themelore, përtej kuptimit të ekzistencës në procesin gjyqësor, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, por edhe të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, kuptohet edhe në rrafshin administrativ, pra shtrirë edhe në rrafshin administrativ. Duhet të kuptojmë që një pjesë jo e vogël e çështjeve që sot kemi në gjykatat shqiptare, vijnë si pasojë e konflikteve ndërmjet subjekteve të caktuara dhe

organeve të administratës publike. Pra, duhet të kuptojmë një nga shkaqet kryesore pse është ky *backlog* sot që po flasim. Pra, analiza që duhet të bëjmë dhe vëmendja që duhet të tërhequr, sepse unë jam i bindur që elementet dhe komponentët e tjerë të komisionit e kanë prekur dhe do ta trajtojnë këtë çështje, është edhe elementi i respektimit të procesit të rregullt ligjor në procedurën administrative, në veprimtarinë e organeve të administratës publike. Nëse respektohet ky element, nëse kemi një vendimmarrje objektive, të drejtë dhe të paanshme, të jeni të bindur që numri i çështjeve që do të shkojnë në gjykatë do të jetë shumë i reduktuar.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Faleminderit, zoti Jaupi, për sjelljen në vëmendje të rëndësisë së respektimit të standardeve të procesit të rregullt ligjor nga organet e administratës publike!

Një ndërhyrje të fundit nga Gjykata e Lartë.

**Bjorka Duka** – Përhëndetje të gjithëve! Bjorka Duka, këshilltare pranë kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Në fakt, unë doja t'ju falënderoj për të gjithë diskutimin dhe për idetë e paraqitura, sepse, në fakt, shumë prej tyre lidhen me shqetësimet që ne i kemi në vëmendje, sidomos në lidhje me *backlog*-un, pavarësisht se Gjykata e Lartë sot gjendet në ditët më të mira që prej ndryshimeve në sistemin gjyqësor. Sot jemi përballë një numri relativisht shumë më të vogël qëkur ka filluar punën, pra jemi në 19 589 çështje që janë ende në pritje të gjykimi dhe në muajin tetor Gjykata e Lartë ka dhënë rreth 800 vendime.

Në përgjigje edhe të shqetësimit të zonjës Hoxha, ne e kemi ndjekur politikën prioritare dhe trajtimin e çështjeve me grupe çështjesh dhe me kategori të caktuara më iniciativën tonë, duke pasur parasysh edhe vendimin e KLGJ-së që u jep prioritet disa kategorive të caktuara të çështjeve, sidomos çështjet e pensionit dhe ato të pensioneve të minatorëve kanë qenë në interes të posaçëm muajit e fundit, ku kemi identifikuar një grup çështjesh, të cilat presim t'i trajtojmë me prioritet dhe t'i planifikojmë në muajt në vijim. Megjithatë, shqetësimi kryesor për ne, që, fatmirësisht, dëgjoj se do të marrë zgjidhje së shpejti është problemi i sistemit informatik, i cili nuk na lejon që të nxjerrim statistika të sakta dhe nuk na lejon që t'i identifikojmë kategoritë e çështjeve në mënyrë të drejtë. Për ata që nuk e njohin sistemin nga brenda, ndonjëherë mund të duket shumë i thjeshtë, por jo gjithmonë objektet e padive të sjella nga avokatët, përkojnë me çështjen, e cila do të trajtohet. Kështu që, shpeshherë është e vështirë që t'i identifikosh çështjet ashtu siç janë. Megjithatë, ne me këtë sistem deri më sot kemi punuar në atë mënyrë për të identifikuar çështjet

që kërkojnë trajtim prioritar, por kjo sjell pastaj probleme edhe në kërkesat për përshpejtim, sepse patjetër, është e drejtë që me kohëzgjatjen që kanë procedurat, sot secili të kërkojë përshpejtimin e procedurave përpara çdo gjykate, në kudër të procesit të rregullt ligjor. Megjithatë, politika e prioritetit që kanë vendosur KLGJ-ja dhe urdhri i Gjykatës së Lartë po në kuadër të kësaj politike prioriteti, u ka dhënë mundësinë disa çështjeve, që janë më sensistive, të trajtohen pak më shpejt se sa të tjerat, paralelisht edhe ato që kërkojnë përshpejtim, por në pamje të parë kjo krijon një ide diskriminimi, sepse disa çështje kalojnë më shpejt, ndërkohë që disa të tjera presin ende përshpejtimin. Ky është një shqetësim që ne po përpiqemi që ta zgjidhim me identifikimin e kategorive të çështjeve. Besoj së në muajt në fillim edhe me analizën që do të paraqesim për komisionin, mund të sjellim edhe gjetjet tona.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Faleminderit, zonja Duka, për prezantimin e situatës dhe mënyrave që Gjykata e Lartë ka gjetur për t'i dhënë zgjidhje problemit të madh të *backlog*-ut dhe trajtimit të çështjeve me prioritet, një pjese të tyre!

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Në fakt, kur flasim për procesin e rregullt, është shumë e vështirë të mbarojnë brenda agjendës, kështu që, besoj se kemi mirëkuptimin tuaj për dy ndërhyrje, sepse edhe zotëria e kishte kërkuar fjalën, meqenëse e kërkoi më parë.

**Armer Juka** – Shumë faleminderit për fjalën!

Unë jam Armer Juka, anëtar i këshillit drejtues të AKEP-it.

Sigurisht, këtu flas nga përvoja ime e mëparshme si avokat dhe, sigurisht, njëfarë përvoje menaxheriale. Jam shumë i lumtur dhe realisht është për t'u përshëndetur fakti që Kuvendi ka vendosur ta marrë në zemër të veprimtarisë së tij mbikëqyrjen e shërbimit gjyqësor përmes këtij komisioni të posaçëm. Shërbimi gjyqësor, si çdo shërbim, i përgjigjet një logjike, po e quaj tregu, ku ka një ofertë dhe një kërkesë. Këtu dua të përfitoj nga ndërhyrja që bëri zoti Jaupi, të cilën e gjej me shumë e vend që, në qoftë se do të vazhdojmë vetëm me idenë që duhet të plotësojmë vakancat, duhet të shtojmë ndihmësit, kjo është shumë e rëndësishme, por një gjë themelore që duhet të kemi parasysh, është fakti që mund të ndodhë si me rrugët, që ne shtrojmë rrugë të reja, bëjmë rrugë të reja, ndërkohë trafiku bëhet më keq. Është themelore që ne të gjejmë mekanizma që numri i çështjeve që shkon në gjykatë, të ulet. Domethënë, ne si shoqëri, për arsye të trashëgimisë sonë historike, jemi të prirur drejt zgjidhjes së mosmarrëveshjes në mënyrë gjyqësore

dhe duhet të gjejmë mekanizma se si çështjet të mos shkojnë në gjykatë, por të zgjidhen paraprakisht. Patjetër, një alternativë, e përmendi kolegu, zoti Dano, është zgjidhja e alternativave të mosmarrëveshjes.

Një tjetër alternativë është vetë burokracia, pra organet administrative të gjejnë mekanizma të rishikimit të brendshëm të vendimeve. Ankimet administrative, nga përvoja ime (nuk kam statistika për t'i dhënë këtu, sigurisht, kjo është ndoshta një punë e këtij komisioni), ankimet e brendshme që bëhen, nuk janë efektive. Pra, ti nuk gjen zgjidhje kur bën një ankim administrativ ndaj një akti të administratës dhe, për mendimin tim, kjo është themelore. Duhet të kemi parasysh që një pjesë e madhe e gjyqeve (dhe përsëri këtu duhet një statistikë, dhe ndoshta ky menaxhimi i integruar i çështjeve që përmendi zoti zëvendësministër, mund të japë një zgjidhje) duhet t'i shikojmë të grupuara; sa çështje kanë lidhje me pronat, me pensionet apo me çështje të tjera, të cilat, në fakt, nuk është se kërkojnë një zgjidhje gjyqësore; është vetëm transferimi i një problemi, i cili nuk është zgjidhur në rrafshin administrativ, që i transferohet sistemit gjyqësor. Besoj se këto grup çështjesh, që zënë një peshë shumë të madhe në gjyqësor, duhen adresuar para se ne të mendojmë vërtet se cilat janë ato *benchmark*-et: pra, sa çështje është e arsyeshme të ketë një gjyqtar në Shqipëri, ose cili është *benchmark*-u europian. Për mendimin tim, kjo është një gjë themelore.

Nga pikëpamja e ofertës, pra përmirësimit i cilësisë, dhe kjo, sigurisht, nga përvoja ime personale, është parimi i oralitetit. Patjetër, ne kemi parimin e oralitetit, pra faktin që kontradikta duhet të diskutohet ballë për ballë në gjykatë, por, për mendimin tim, mënyra se si është interpretuar parimi i oralitetit është i gabuar dhe është abuzuar me të. Oralitet do të thotë që ti e ke mundësinë në një moment të caktuar në seancë gjyqësore të diskutosh ballë për ballë çdo argument dhe çdo provë që është paraqitur në proces. Domethënë, kjo nuk do të thotë se çdo moment i procesit duhet të jetë oral dhe numri i seancave gjyqësore ku një avokat duhet të paraqitet apo një palë, kur është papërfaqësuar me avokat, është jashtëzakonisht i lartë, duhet të jetë stilistikisht ndër më të lartat në botë. Pra, duhet gjetur një mekanizëm, pra duhet që deri në momentin që dosja të bëhet gati për gjykim kontradikta të ofrohet nëpërmjet komunikimit me shkrim, me *email* apo me postë. Pa adresuar këto çështje, pra që kërkesa për shërbime gjyqësore si nga pikëpamja e numrit, si nga pikëpamja e kohës që i merr gjykatës, pa u trajtuar këto, kam përshtypjen se fokusimi vetëm te përmirësimi i cilësisë së gjyqësorit, nuk do të jetë i plotë, dhe shpresoj dhe uroj që ky komision dhe këto grupe pune, që janë ngritur përbri tij, t'i adresojë këto çështje.

Faleminderit!

Më falni që ju mora pak kohë!

**Ina Xhepa** – Faleminderit për ndërhyrjen tuaj dhe për prezantimin e disa elementeve, që mund të jenë mjaft me vlerë për zgjidhjen e problematikave të sistemit!

Në funksion të moderatorit, të pjesës së parë të tryezës, është ndërhyrja e fundit.

**Romina Kostani** – Faleminderit!

Jam Romina Kostani, drejtoreshë e Agjendës Digjitale tek AKSH-i.

Në vijim të asaj që përmendi edhe zoti Dobi, unë thjesht doja t'ju bëja me dije për sa i përket ndërveprimit midis institucioneve të pavarura dhe të gjyqësorit me sistemet qeveritare. Konkretisht, ne kemi pasur një sërë diskutimesh gjatë viteve të fundit, dhe më në fund kemi arritur një dakordësi, në mënyrë që sistemet e gjyqësorit, konkretisht sistemi ICMS, i cili është duke u ngritur aktualisht, të ketë mundësi ndërveprimi me sistemet elektronike qeveritare përmes platformës qeveritare të ndërveprimit, në të cilën aktualisht ndërveprojnë 63 sisteme, ndërkohë janë në proces shtimi të tjera sisteme elektronike.

Në fakt, është bërë një diskutim i gjatë, dhe kjo dakordësi është pjesë edhe e reformës së agjendës, konkretisht ndërveprimi mes sistemeve elektronike qeveritare me sistemet e gjyqësorit, thjesht për informimin e të gjithëve ne që është diçka që do të ndodhë që do të lehtësojë dhe do të përshpejtojë shumë procese gjyqësore.

Faleminderit!

**Ina Xhepa** – Faleminderit për ndërhyrjen dhe për prezantimin e kësaj të reje, e cila besoj se do të bëhet e prekshme shumë shpejt për të gjithë përdoruesit e sistemit gjyqësor. Në fakt, koha nuk është asnjëherë e mjaftueshme kur ne flasim për procesin e rregullt ligjor, duke u ndalur tek aksesimi efektiv në drejtësi, respektimi i afatit të rregullt ligjor, garancitë e tjera procedurale për prezumimin e pafajësisë dhe ekzekutimi efektiv i vendimeve gjyqësore përfundimtare. Besoj se të gjitha diskutimet e ndodhura sot gjatë pjesës së parë të tryezës, janë një vlerë e shtuar e analizës së përgatitur, më saktë draftanalizës, nga komisioni i posaçëm parlamentar, analizë e cila do të pasurohet me të gjitha gjetjet e këtij diskutimi.

Kështu po e mbyll këtë pjesë të parë, duke pasur kënaqësinë t'ia lë fjalën koleges sime, zonjës Olta Aliaj, për të moderuar panelin e dytë të tryezës së sotme për rëndësinë e edukimit ligjor të publikut.

**Olta Aliaj** – Faleminderit, Ina!

Pjesën e dytë ia kemi dedikuar edukimit ligjor të publikut.

Edukimi ligjor i publikut është mjaft i rëndësishëm për dy arsye:

Së pari, sepse informon dhe ndërgjegjëson qytetarët për sistemin e drejtësisë dhe për normat ligjore, në mënyrë që ata t'i kuptojnë dhe më pas t'i zbatojnë në mënyrë korrekte.

Arsyeja e dytë është, se nëpërmjet një gjëje të tillë forcohet shteti i së drejtës dhe llogaridhënia nga ana e institucioneve shtetërore.

Edukimit ligjor publik nuk i është dhënë një vëmendje e veçantë deri në momentin kur është përpiluar dokumenti analitik i reformës në drejtësi, pra analiza që u bë në vitin 2015. Në fakt, në këtë analizë u evidentua rëndësia e edukimit ligjor të publikut, si element i rëndësishëm për të krijuar kulturën juridike të qytetarët dhe për të promovuar edhe një aktinizëm qytetar, mbi të gjitha, për të forcuar atë qasjen e qytetarit tek institucionet e drejtësisë. Analiza vuri në dukje që edukimi ligjor i publikut bëhej në mënyrë të paorganizuar, në mënyrë sporadike dhe në mënyrë të paplanifikuar. Aktualisht janë bërë hapa pozitivë me miratimin e Strategjisë për Edukimin e Publikut 2019-2023 dhe planit të saj të veprimit. Të dyja këto dokumente kanë si qëllim kryesor të krijojnë një sistem harmonik dhe një sistem të mirëkoordinuar të edukimit ligjor të publikut.

Gjithashtu, dua të theksoj pak edhe rolin e rëndësishëm që kanë institucionet e pavarura në këtë drejtim. Për shembull, Avokati i Popullit, si institucion kombëtar, që mbron dhe promovon të drejtat e njeriut, nuk është vetëm një institucion që merr ankesa, por bën shumë edhe në drejtim të promovimit të të drejtave të njeriut të qytetarët dhe të fëmijët, pra tek të gjitha shtresat e popullsisë, duke promovuar rolin e tij, por njëkohësisht duke dhënë informacion për të drejtat dhe detyrimet që kanë qytetarët. Megjithatë, pavarësisht se në këtë fushë janë bërë hapa pozitivë, nga zbatimi në praktikë i strategjisë dhe i kuadrit ligjor, është vënë re se ende ka sfida, të cilat duhen adresuar dhe të cilat ne i kemi analizuar në kuadër të komisionit të posaçëm parlamentar. Për të folur më shumë për këto sfida më në detaje, unë dua t'ua jap fjalën dy kolegeve tona, Nadias dhe Inës për të paraqitur gjetjet dhe sfidat kryesore për sa i përket edukimit ligjor të publikut.

**Nadia Rusi** – Faleminderit, Olta!

Së pari, dua t'ju informoj për sa i përket zgjedhjes sonë për të bashkuar këta dy komponentë të rëndësishëm në këtë tryezë konsultimi të parë në kontekstin e sundimit të ligjit dhe nënkomponentit të të drejtave themelore. Siç edhe e vumë re nga diskutimet në pjesën e parë të tryezës një nga elementet më të rëndësishme, që lidhet me aksesin në drejtësi dhe qasjen në drejtësi të të gjitha kategorive vulnerabël, ka të bëjë me informimin ligjor dhe me edukimin ligjor të

publikut. Kjo bëri që ne t'i bashkojmë këta dy komponentë të rëndësishëm të të drejtave dhe lirive themelore të individëve në tryezën e sotme të diskutimit.

Nga ana tjetër, unë do të doja që në fillim të vija theksin te qasja që kemi ndjekur për sa i përket analizës në lidhje me edukimin ligjor të publikut, nëse u referohemi raporteve të progresit të Komisionit European, por edhe raporteve të organizatave të tjera, gjithmonë nënkomponenti i edukimit ligjor të publikut është parë brenda shtyllës së qasjes në drejtësi dhe procesit të rregullt ligjor. Për këtë do të doja t'ju thosha që në fillim se, në fakt, analiza jonë ka shkuar në komponentin e edukimit ligjor të publikut edhe përtej të dhënave, konkluzioneve dhe vlerësimeve të raportprogresit dhe dokumenteve të tjera analitike që kanë udhëhequr të gjithë komponentët e tjerë, për të parë edhe se cilat janë problematikat reale në kontekstin shqiptar, si dhe për t'u njohur me natyrën tjetër të problematikave të sjella, qoftë nga institucione të sistemit të drejtësisë dhe institucione të tjera ligjzbatuese në vend, qoftë edhe nga pikëpamjet e organizatave të shoqërisë civile dhe organizatave të tjera me karakter ndërkombëtar.

Pra, në kontekstin e referencës së kësaj pjese të analizës, të dhënat janë marrë jo vetëm nga raportprogreset edhe dokumentet që kanë udhëhequr të gjithë qasjen e komponentëve të tjerë, por, gjithashtu, edhe duke parë situatën aktuale në realitetin tonë, në kuadër të edukimit ligjor të publikut. Të imagjinojmë një shoqëri në të cilën askush prej nesh në këtë sallë të mos njihte asnjë prej të drejtave ligjore. Pra, ta imagjinonim në një moment të ardhmen tonë sikur nuk do të kishim asnjë informacion në lidhje me gjithçka që mund të na diktonte jetën tonë apo të na shoqëronte. Sa konfuzë mund të bëheshim për sa i përket çështjes së zgjidhjes së tyre apo të ndërvendosjes së marrëdhënieve tona në shoqëri!

Pse edukimi ligjor i publikut është një komponent i rëndësishëm i sundimit të ligjit në shoqëri dhe i shtetit të së drejtës?

Së pari, sepse përmirëson qasjen në drejtësi të të gjitha kategorive dhe grupeve. Këtu flas jo vetëm për kategoritë dhe grupet, të cilat kanë njohuri dhe mundësi që të mund të njohin të drejtat e tyre përmes metodave të ndryshme që ekzistojnë, por sidomos me fokus te kategoritë vulnerabël, tek të miturit apo fëmijët, viktimat e dhunës me bazë gjinore, pakicat etnike minoritare, të cilat kanë më pak akses në edukimin ligjor të publikut.

Së dyti, e kemi parë si një komponent mjaft të rëndësishëm, i cili do të ndikonte në rritjen e besimit të të gjithë qytetarëve në sistemin ligjor. Pra, sa më të informuar të jenë individët për sa i përket sistemit ligjor, aq më shumë mund të rritet besimi i tyre në sistemin që udhëheq çështjet e

të drejtave të njeriut dhe drejtësisë. Gjithashtu, edukimi ligjor i publikut është konsideruar në këtë analizë si një element mjaft i rëndësishëm, i cili do të ndikonte në reduktimin e shkeljeve, ashtu edhe në zvogëlimin e konflikteve ligjore, në kontekstin e njohjes së të gjitha të drejtave që mund të kenë individët.

Së fundi, për sa i përket rëndësisë, analiza e vendos theksin në lidhjen që edukimi ligjor i publikut ka në fuqizimin e sundimi të ligjit për një shoqëri më të drejtë. Pra, të gjitha këto elemente ne i kemi vlerësuar mjaft të rëndësishme dhe që janë pjesë e dokumentit analitik në lidhje me komponentin e edukimit ligjor të publikut.

Për sa u përket çështjeve, të cilat mundet të lidhen me situatën aktuale dhe rrugëtimin drejt politikave të edukimit ligjor të publikut, ashtu siç, në fakt, u përmend edhe nga Olta, vëmendja e parë në lidhje me këtë komponent të edukimit ligjor të publikut ka ardhur në vitin 2015 në kontekstin e Reformës në Drejtësi, e paketës së ligjeve, ku një nga nënkomponentët e kësaj reforme ka qenë pikërisht edhe edukimi ligjor i publikut, si dhe analiza e kryer në këtë kontekst për sa i përket situatës aktuale në lidhje me edukimin ligjor të publikut. Kjo u pasua në vitin 2019 me miratimin e të parës Strategji Kombëtare për Edukimin Ligjor të Publikut 2019 -2023, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, duke u pasuar një vit më vonë me hartimin e të parit plan kombëtar për edukimin ligjor të publikut nga Ministria e Drejtësisë për sa u përket vendosjes së masave dhe aktiviteteve të parashikuara në mënyrë konkrete në kontekstin e edukimit ligjor të publikut. A ishin këto progres? Patjetër që po. Për herë të parë ne kemi një strategji të mirëfilltë dhe për herë të parë kemi një plan kombëtar veprimi.

Çfarë tregoi analiza? Analiza tregoi që në fund të zbatimit të kësaj strategjie më pak se 40% e masave të planifikuara ishin realizuar, që do të thotë, a ka nevojë për vëmendje në përfundim të zbatimit të afatit kohor të këtij dokumenti strategjik? Patjetër që po. Pra, analiza tregon që në kontekstin e të gjithë vlerësimit që ne i kemi bërë këtij dokumenti analitik, meritohet një vëmendje e shtuar për sa i përket edhe vendosjes së masave konkrete dhe përcaktimit të aktorëve konkretë përgjegjës për sa i përket zbatimit të edukimit ligjor të publikut.

Nga ana tjetër, unë e theksova që kemi pasur një përpjeke shumë të mirë me miratimin e të parit dokument në nivel kombëtar, por që prej vitit 2023 nuk kemi një tentativë tjetër për sa i përket zëvendësimit apo miratimit të një dokumenti të tillë të kësaj natyre. Unë do të doja të nënvizoja faktin që në kontekstin e përpjekjeve të institucioneve të tjera analiza ka marrë në konsideratë të gjitha përpjekjet e institucioneve, sidomos të sistemit të drejtësisë. Ministria e Drejtësisë dhe

Komisioni European në progresraportin e fundit kanë evidentuar rëndësinë që ka pasur miratimi i strategjisë për viktimat e krimit, por, gjithashtu, edhe miratimi i strategjisë së re ndërsektoriale të sistemit të drejtësisë, të cilat duhet ta ketë në fokus të tyre edukimin ligjor të publikut, si dhe nga viti 2022 miratimin e planeve të komunikimit, qoftë të gjykatave, qoftë të Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, qoftë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, qoftë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për sa u përket përcaktimit të masave të edukimit ligjor të publikut.

A janë këto të mjaftueshme? Dhe, nga ana tjetër, a ndihmojnë këto masa, të cilat mund të konsiderohen si masa të rëndësishme për vetë institucionin në kontekstin e komunikimit dhe edukimit ligjor, për të garantuar të drejtën për edukim ligjor publikut për të gjithë individët? Këtë ne e kemi konsideruar si një çështje që meriton vëmendje dhe që, nga ana tjetër, do të donim ta konsultonim me ju në kontekstin e vlerësimit apo të diskutimeve për efekte të kësaj tryeze.

Për sa u përket elementeve të tjera që konsiderohen ose që lidhen me çështjet e edukimit ligjor të publikut, në tryezën apo në diskutimin pararendës u vendos theksi edhe në rolin që luan Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas. Për ndihmën ligjore falas në çështjet e edukimit ligjor të publikut, unë do të doja të sillja në vëmendje për ju disa nga të dhënat që ne kemi edhe në kontekstin e analizës së vlerësimit. Deri në vitin 2021, në fakt, rrjeti i ndihmës juridike falas u zgjeruar me 8 qendra dhe në vitin 2023 ne kemi 20 qendra të ndihmës juridike falas dhe, gjithashtu, 15 organizata të shoqërisë civile, të cilat janë të licencuara nga Ministria e Drejtësisë dhe 12 klinika ligjore, të cilat ofrojnë ndihmën juridike falas.

Megjithatë, raportet e Komisionit European për Shqipërinë evidentojnë se funksionaliteti i plotë i këtyre klinikave varet nga alokimi i fondeve të dedikuara nga buxheti i shtetit. Çfarë dua të them me këtë? Në kontekstin e analizës ne kemi bërë një vlerësim të buxhetit të shtetit për sa i përket ndihmës juridike falas, duke filluar nga viti 2020 deri në vitin 2024. Ajo çka kemi konstatuar është se ka një rritje graduale të buxhetit të shtetit për sa i përket alokimit të fondeve dhe planifikimit të fondeve për ndihmën juridike falas. Megjithatë, analiza përsëri e vendos theksin te përqindja që ky buxhet zë ndaj totalit të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë. Pra, me gjithë rritjen e buxhetit të shtetit, ndihma juridike falas sot merr më pak se 1% të buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë, gjë që ne mendojmë se mund të konsiderohet si një nga fushat e ndërhyrjeve apo e propozimeve që mund të vijë edhe për efekt të këtij vlerësimi dhe këtij dokumenti analitik.

Nga ana tjetër, raportet e progresit për vitet 2022 dhe 2023, zbulojnë një shqetësim që ne e kemi parë me rëndësi për ta bërë pjesë të analizës, ndonëse ekziston një kuadër ligjor i

mirëpërcaktuar për sa i përket edukimit ligjor dhe ndihmës juridike falas. Qasja faktike të fëmijët mbetet në mënyrë disproporcionale e ulët, për ta lidhur edhe me diskutimet që ne kishim në pjesën e parë të tryezës së diskutimit të sotëm. Pra, këto raporte të progresit theksojnë se vetëm një numër i vogël fëmijësh përfitojnë ndihmë juridike, krahasuar me numrin e tyre të përfshirë në proceset penale, familjare, civile dhe administrative. Për më tepër, raportet e Komisionit European theksojnë, gjithashtu, nevojën për një qasje të ndjeshme ndaj gjinisë për sa u përket viktimave, qoftë viktimave të dhunës në familje, qoftë viktimave të trafikimit.

Në mënyrë të ngjashme, Komiteti për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave, ka shprehur shqetësime për sa i përket këtij komponenti të edukimit ligjor, veçanërisht në lidhje me viktimat e dhunës me bazë gjinore, duke vënë theksin te mungesa e njësive të specializuara për dhunën me bazë gjinore, në gjykata, në prokurori apo në polici, të cilat ndikojnë në efektivitetin e shërbimeve të ndihmës juridike. Të gjitha gjetjet nënvizojnë nevojën kritike për forcimin e sistemit të ndihmës juridike në Shqipëri për t'u shërbyer sa më mirë të gjitha këtyre grupeve të marginalizuara.

Në kontekstin e sfidave për sa i përket edukimit ligjor të publikut, siç ju edhe e shihni në ekranin që keni përpara, ne kemi evidentuar disa nga sfidat për sa i përket edukimit ligjor të publikut. E para, të gjitha *puzzle*-at do të duhet të bashkohen për të pasur një qasje të koordinuar dhe një funksionim të koordinuar të institucioneve me njëra-tjetrën dhe krijimit të rrjetit kombëtar të edukimit ligjor të publikut. Do të doja ta theksoja se ka qenë një nga detyrat që u vendos në Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut krijimi i rrjetit kombëtar dhe forcimi i tij.

Së dyti, ju e shihni që një nga aspektet e sfidave që ne përsëri i kemi evidentuar, për ta lidhur edhe me procesin e rregullt, është Harta Gjyqësore, për të parë se cilat janë sfidat e edukimit ligjor të publikut. Nga një studim i fundit, i kryer mbi aksesin në drejtësi të realizuar nga UNDP-ja për sa i përket qasjes në drejtësi, pas vitit të raportit të parë të vlerësimit kombëtar 2017, është evidentuar se vetëm 1/3-ta e popullsisë sot ka njohuri mbi sistemin e ndihmës ligjore falas. Ky është një tregues mjaft i rëndësishëm për ne, që duhet të merret në konsideratë nga ky komision për sa u përket propozimeve për ndërhyrje në kontekstin e rritjes së qasjes së qytetarëve shqiptarë në informacionin ligjor, në informacionin mbi të drejtat e tyre dhe, nga ana tjetër, mbi strukturat dhe mekanizmit për sa i përket edukimit ligjor të publikut.

Një tjetër sfidë që ne e kemi parë me rëndësi në kontekstin e edukimit ligjor të publikut është theksi te grupet vulnerabël, personat me aftësi të kufizuar në dëgjim edhe në shikim. Pra,

janë dy kategori, të cilat meritojnë një vëmendje të shtuar për sa i përket ndërmarrjes së nismave konkrete, me qëllim që pavarësisht barrierave që ata kanë në kontekstin e aftësisë së tyre të kufizuar, të kemi sot një mundësi më shumë që të dyja këto kategori vulnerabël të mund të informohen në lidhje me të drejtat e tyre dhe të marrin informacion ligjor për çështjet, konfliktet apo edhe problematikat që mund të kenë.

Distancat gjeografike janë një tjetër sfidë për sa i përket edukimit ligjor të publikut. Ju aty shihni një urë që, në fakt, e bën të pamundur të merret informacioni ligjor i publikut nga të gjithë qytetarët, të cilët ndodhen në zonat më të thella, më të largëta. Aktualisht, kemi 20 qendra të ndihmës juridike, por po të shohim vendndodhjen e këtyre qendrave, në fakt, situata apo analiza tregon që nuk ka mjaftueshëm akses për sa i përket qasjes në informacionin ligjor të grupeve që janë pjesë e zonave rurale apo zonave më të thella, pavarësisht të gjitha përpjekjeve që janë bërë dhe janë evidentuar për aspektet në kontekstin e kësaj analize nga ndihma ligjore falas dhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë.

### Digjitalizimi

Qasja në informacionin ligjor përmes mjeteve dhe teknologjisë është një tjetër risi, një tjetër element që është marrë në konsideratë në këtë analizë, por që ne e kemi klasifikuar edhe këtë element ndoshta si pjesë të sfidave të sotme të edukimit ligjor të publikut. Pra, ne shohim shërbime dhe platforma *online* që janë një mundësi e mirë e shtuar për të marrë informacion ligjor, por kjo patjetër që ka nevojë të shoqërohet edhe me edukimin e kategorive që e kanë të pamundur të përdorin teknologjinë. Të moshuarit nuk mund ta marrin informacionin ligjor në një masë të madhe përmes përdorimit të teknologjisë dhe për këtë arsye do të duhet që kjo analizë të mund të diskutojë edhe çështje se si mundet që këto kategori, pavarësisht pengesave dhe sfidave në edukimin ligjor, të mund të marrin informacionin e tyre.

I fundit, por jo më pak i rëndësishëm, është buxheti, pra sfidat që lidhen me buxhetin e ndihmës juridike falas, buxhetin që do të duhet të jepet për sa i përket edukimit ligjor të publikut, në mënyrë që këto të mos pengojnë askënd për t'u qasur sistemit të drejtësisë, gjithashtu edhe edukimit në të gjitha çështjet ligjore. Këto janë disa nga sfidat që ne i kemi vlerësuar në kontekstin e të gjithë kësaj analize. A ka nevojë për ndërhyrje? Pra, cilat janë parë në kontekstin e analizës si katër elementet e rëndësishme për sa i përket një ndërhyrjeje në kontekstin e edukimit ligjor të publikut?

E para, vlerësimi kombëtar i nevojave është parë si një nga aspektet apo fushat në të cilat është elaboruar nevoja për ndërhyrje në kuadër të dokumentit analitik.

Së dyti, qytetari në fokus, pra ndërmarrja e iniciativave apo fushave që do të duhet ta kenë qytetarin nga të gjitha kategoritë në fokus, në mënyrë që të kemi një qasje më të drejtë të tij në sistemin ligjor.

Infrastruktura e përshtatshme, e cila, siç unë e theksova, shmang atë sfidën e barrierave gjeografike dhe kulturore, nga ana tjetër.

Fusha e katërt që ne kemi propozuar si pjesë e ndërhyrjes janë burimet financiare të qëndrueshme për sa i përket edukimit ligjor të publikut.

Këto janë disa nga çështjet që ne kemi konsideruar për efekte të analizës në kontekstin e edukimit ligjor të publikut dhe në kuadër të tezave për diskutim, të cilat do të donim të ishin në vëmendjen tuaj për të na ndihmuar për përmirësimin e këtij dokumenti analitik. Pra, cilat vlerësoni ju, nga eksperiencia juaj, se janë pengesat kryesore që e kanë penguar një edukim të mirëkoordinuar ligjor në vendin tonë? Si mund të sigurohet një qasje më e qëndrueshme dhe e institucionalizuar e edukimit ligjor të publikut? Pra, të mos kemi qasje të fragmentarizuar për sa i përket garantimit të edukimit ligjor. Si mund të përfshihen më mirë grupet vulnerabël në këtë proces? Dhe, nga ana tjetër, çfarë roli mund të kenë institucionet shtetërore, shoqëria civile dhe organizatat ndërkombëtare në përmirësimin e edukimit ligjor të publikut?

Mua më vjen shumë mirë që në kontekstin e të gjitha këtyre pyetjeve ne sot kemi në tryezë përfaqësues të secilës prej këtyre targetgrupeve, të cilat mund të na japin këndvështrimin dhe kontributin për sa i përket përmirësimit të dokumentit analitik, nga njëra anë, por, nga ana tjetër, edhe ajo çka është më e rëndësishme, ndërmarrja e iniciativave me rëndësi për përmirësimin e edukimit ligjor të publikut në tërësinë e tij.

Faleminderit për vëmendjen, për sa i përket kontekstit të parë në lidhje me përmbajtjen e dokumentit apo draftdokumentit analitik, mbi edukimin ligjor të publikut!

**Olta Aliaj** – Faleminderit, Nadia, për këtë paraqitje të detajuar të gjetjeve dhe problematikave, sidomos për vënien e theksit te grupet vulnerabël, pasi pikërisht ata hasin më tepër vështirësi në aksesin në drejtësi!

Diskutimi është i hapur për komente apo për sugjerime që mund të keni.

Po, Alma.

**Alma Tandili** – Përshëndetje të gjithëve!

Unë jam Alma Tandili, kryetare e Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës.

Ju falënderoj përzemërsisht për këtë iniciativë!

Në fakt, ky është një detyrim i madh ligjor që ne kemi bashkërisht, të gjitha institucionet dhe shoqëria civile. Kur flasim për pjesën e grupeve vulnerabël, interesin më të lartë ne kemi atë të fëmijëve.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po tani, dëgjohe?

Vazhdojmë. Në qoftë se keni ndonjë përkthim...

Tani?

Më falni, por me sa duket është me shumë rëndësi.

Ajo që po thosha është se kur flasim për çështjen e fëmijëve, është një tematikë që na prek të gjithëve. Edukimi ligjor duhet të fillojë që në kopsht, në shkollë, në çerdhe. Në çerdhe, pa diskutim e kam fjalën për stafin, ku çdo individ, çdo qytetar, mbase është e vështirë, por çdo strukturë shtetërore, publike dhe private duhet të njohë ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, është detyrim ligjor. Nga të dhënat tona si agjenci, ne kemi informacion se jo të gjithë e njohin ligjin “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, qoftë edhe nga institucionet brenda strukturave tona, qoftë edhe nga sektori privat, por kjo është shumë e rëndësishme. Pse e them këtë? Më lejoni, se ndoshta do të zgjatem, por për ne është elementi kryesor çështja e fëmijëve dhe të drejtat e mbrojtjes për sa i përket edhe sektorit privat, edhe bizneseve. Pse? Problemi është që aty ka shumë prindër që punojnë dhe nuk e njohin pjesën e të drejtave të fëmijëve, mbrojtjen e tyre dhe janë ata që përballen me problemin e konflikteve, pra është ajo që tha zoti Jaupaj, dhe unë e përgëzoj, që ne duhet t’i parandalojmë rastet, nuk kemi pse të shkojmë të gjithë te pjesa e gjyqësorit.

Unë ju falënderoj përzemërsisht, duke qenë se vitet e fundit ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” në vitin 2017 i dha një risi ndërgjegjësimit publik. Ne kemi në mbrojtje 2200 fëmijë dhe kjo tregon që ka një ndërgjegjësim për sa i përket mbrojtjes së tyre nga çdo formë e dhunës, abuzimit dhe neglizhimit, por ndiej të them që pa diskutim ka shumë sfida pjesa e prokurorisë dhe e gjyqësorit, pasi ne kemi një lloj empatie nga prokuroria dhe gjykata, më lejoni ta them, ndoshta unë si kryetare, nga të dhënat që kemi, kur vjen fjala për vendimet gjyqësore, për hapat që merren, edhe për vendimet e prokurorëve për sa u përket çështjeve të fëmijëve në konflikt

me ligjin, nuk ka shumë dënime. Sigurisht, nuk është në interesin më të lartë që ne të dënojmë fëmijët, por patjetër që ka raste, të cilat ata i trajtojnë me shumë delikatesë, duke ftuar specialistë edhe nga sektorë të shërbimeve sociale të bashkisë. Pra, ka një bashkëpunim, ka një ndërgjegjësim të publikut, por edhe të institucioneve për sa i përket bashkëpunimit ndërinstitucional.

Një pikë tjetër që unë e shikoj me shumë rëndësi është pjesëmarrja e fëmijëve në konsultimet publike për sa u përket zbatimit të strategjive ndërsektoriale ku preken çështjet e fëmijëve. Në fakt, ne e kemi ngritur, me UNICEF-in, me shoqërinë civile, me organizatat “*Save the Children*”, “*World Vision*” dhe me shumë organizata që punojnë në Shqipëri, çështjen e pjesëmarrjes së fëmijëve në procese konsultimi, edhe me grupin e deputetëve “*Miqve e Fëmijëve*” të që kemi në Kuvend. Kjo është një risi shumë e mirë, sepse ata e ndiejnë veten shumë të përfaqësuar, por do të donim që për këtë përfaqësim të fëmijëve, pjesëmarrja në procese konsultimi të ishte edhe nëpër bashki me detyrim ligjor. Pra, edhe pjesa e buxhetimit për ta të ishte me shumë prioritet.

Një kërkesë tjetër që ne kemi është që në çdo proces konsultimi çështja e fëmijëve dhe e të drejtave të të miturve dhe të rinjve pa diskutim duhet të jetë në plan të çdo ministrie. Mbase jam empatike dhe emocionale, sepse punoj çdo ditë me çështjet e fëmijëve, por edhe për çdo kryetar bashkie duhet të jetë prioritet çështja e të miturve. Çdo kryetar bashkie duhet të ketë, duhet të njohë në listën që ka (apo në listën e institucioneve patjetër që e keni) me prioritet personat apo familjet që kanë fëmijët me rrezik të ulët, të mesëm, të lartë; duhet të jetë detyrim ligjor që ta ketë në *prescreen*-in e vet, që ne të parandalojmë shumë raste dhe të mos shkojmë te pjesa e gjyqësorit dhe e prokurorisë, që janë hallkat e fundit, sepse pastaj detyrohemi të ndërhyjmë me procedura të tjera.

Ajo që shikoj tjetër me shumë interes është që për sa i përket prokurorisë dhe gjykatave, kolegët tanë janë të superngarkuar dhe duke qenë të tillë sigurisht që çështja e fëmijëve është shumë prioritare. Një çështje e rëndë, e dhunës dhe e krimit në familje, abuzimeve seksuale që ne kemi trajtuar për vite me radhë...

Dhe dua t’u them: faleminderit! Pse ekzistojnë këto? Këto ekzistojnë globalisht, jo vetëm në Shqipëri.

Është çështje shumë intime dhe shumë e vështirë për ta identifikuar, por ne kemi rritur përgjegjshmërinë te prokurorët dhe gjyqtarët, por duhet të kenë edhe ata seksionet e tyre, njësitë që ju përmendët, Nadia, për sa u përket njësive të specializuara të dedikuara për çështjen e

fëmijëve, sepse ato janë prioritare. Dhuna dhe krimi nuk pret. Ne sot kemi problematika me psikologët në komisarate, në të gjithë Shqipërinë. Ky është një problem që duhet ta zgjidhë Prokuroria e Përgjithshme, se e ka marrë bashkë me Urdhrin e Psikologut, me policinë. Për ne, garantimi sipas Konventës së të Drejtave të Fëmijëve duhet të jetë i zgjidhur menjëherë. Figura e psikologut është emergjente. Dhuna nuk pret, fëmija nuk pret, rastet nuk presin. Sigurisht që politikat tona janë për të parandaluar sa më shumë raste, por i kemi ato raste, duhet t'i kemi profesionistët e vijës së parë aty.

Tjetër, është me rëndësi, që për të mos shkuar te gjykata dhe prokuroria, zyrat e ndërmjetësimit duhet të jenë të detyrueshme.

Më falni, për përkthyesit, por...

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Ndoshta nuk e di kur do të jem në tryezën tjetër.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Faleminderit shumë!

E fundit, që është e rëndësishme, ka të bëjë me zyrat e ndërmjetësimit në çdo bashki. Mbase në çdo njësi administrative, do të ishte një ëndërr për ne, por në çdo bashki do të ishte shumë e rëndësishme. Problemin më të madh te fëmijët dhe tek të miturit ne e kemi në proceset e divorceve, për shkak të problematikave, të konflikteve të tyre në çdo familje, qoftë tek ato me të ardhura ekonomike mbi mesataren, qoftë nën mesataren. Ky është një problem që nuk po e shikojmë vetëm te familjet e varfra, që është një stigmatizim gjithmonë edhe tek ata që janë akoma më vulnerabël, por po e shikojmë edhe te familjet që kanë edhe persona me shumë influencë, pasi po na kthehen në një problem shumë të rëndë, sa që jemi të detyruar të ndërhyjmë me zyrë përmbarimi, me Policinë e Shtetit, me forcë. Kjo është...!

Ne jemi të detyruar të zbatojmë ligjin për sa i përket mbrojtjes së fëmijëve. Zyra e ndërmjetësimit do të na ndihmojë jashtëzakonisht për të sheshuar konfliktin, për interesin më të lartë. Ne detyrohemi të shtunë, të diel...

Pra, punonjësi i mbrojtjes së fëmijës nuk e ka me detyrim ligjor të shkojë në takimet periodike të prindërve, nuk e ka, por gjykata e vendos, zyra e përmbarimit i vendos edhe gjoba punonjësit të mbrojtjes së fëmijës kur nuk shkon, sepse aq kapacitete kemi.

Kështu që të gjitha këto dinamika që unë solla sigurisht që vijnë në një pikë të përbashkët, që është mbrojtja e fëmijëve. Fëmijët janë të gjithë tanët.

Ju falënderoj shumë!

Siç e tha edhe zoti Xhafaj, do të jemi bashkërisht, dhe ju falënderoj me zemër që ndoshta iniciativa të tilla do të na ndihmojnë të gjithëve dhe do të bëjmë gjëra shumë të mira, siç kemi bërë!

**Olta Aliaj** – Faleminderit, Alma, për të gjitha këto sugjerime!

Absolutisht që fëmijët janë kategori vulnerabël dhe janë një kategori që duhet t’i ushtohet një rëndësi e veçantë nga të gjitha institucionet, duke përfshirë këtu edhe institucionet e drejtësisë. Në njësitë për mbrojtjen e fëmijës nëpër bashki është shumë e rëndësishme të rriten kapacitetet, të rriten burimet njerëzore dhe burimet financiare, sepse punonjësit që janë në vijë të parë, që merren me menaxhimin e rasteve, dhe kemi nevojë imediate për t’i rritur këto kapacitete.

Për sa u përket trajnimeve, gjithashtu, dua ta vendos theksin edhe tek trajnimet e profesionistëve që punojnë me fëmijët. Është shumë e rëndësishme të bëhen këto lloj trajnimesh. Si komisionere për mbrojtjen e fëmijëve, brenda seksionit ne bëjmë shumë aktivitete, ditë të hapura, për të ndërgjegjësuar dhe informuar jo vetëm fëmijët, por edhe mësuesit, ata që merren çdo ditë me fëmijët, për konventën, për ligjin “Për mbrojtjen e fëmijës”, megjithatë ka ende shumë-shumë punë për të bërë.

Po, fjalën e ka zëvendësministrja.

**Nina Guga** - Faleminderit!

Përshëndetje të gjithëve!

Në radhë të parë, ju përgëzoj shumë për këtë tryezë, ku secili nga ne gjen veten për të thënë diçka në lidhje me këtë temë sensitive, që ka të bëjë edukimin ligjor për të gjithë shoqërinë, aq më shumë që unë përfaqësoj Ministrinë e Arsimit dhe jam zëvendësministre që mbuloj arsimin parauniversitar, pjesën që këtu u diskutua gjatë për rolin që institucionet arsimore dhe të gjitha institucionet ndërvepruese duhet të kenë me njëri-tjetrin, pikërisht për të pasur në fokus mirëqenien e fëmijëve dhe arsimimin e tyre në mënyrën më të mirë të mundshme! Ndaj, e gjej me shumë vend të them që edhe ne si Ministri e Arsimit edukimin ligjor e kemi pjesë të strategjisë së edukimit ligjor të publikut nëpërmjet kurikulës sonë arsimore.

Pra, në kurikulën tonë, në lëndën e qytetarisë nga klasa e parë deri në të dhjetën zhvillohen dhe trajtohen tematika të ndryshme, që kanë të bëjnë me njohjen e ligjit, me njohjen e Kushtetutës, me të drejtat dhe detyrat, me liritë, me të gjitha detyrimet që ata duhet të njohin sipas grup-moshave që kurikula jonë ka nga klasa e parë deri në klasën e dhjetë. Kjo është njëra anë, kurse ana tjetër,

që e përmendët edhe ju, është pjesa e trajnimit të mësuesve që merren direkt me këtë pjesë të fëmijëve. Në kurikulën e trajnimit të mësuesve kemi tashmë manuale dhe module, të cilat ata i kanë pjesë të punës së tyre të përditshme, por nuk ka munguar edhe bashkëveprimi dhe bashkërendimi që Ministria e Arsimit ka edhe me shumë organizata, siç u përmend edhe nga Alma edhe në panelin e parë, që ndërveprojnë me njëra-tjetrën dhe që kanë në themel të punës së tyre pikërisht mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të fëmijëve tanë.

Në këtë pikë, a ka vend për përmirësim në kurikulën tonë apo në kurikulën e trajnimit të mësuesve? Besoj se po. Ne si Ministri e Arsimit jemi duke ndërmarrë reforma të rëndësishme në drejtim të kornizës kurikulare. Dje ne kemi lançuar miratimin e kornizës kurikulare në qasjen e modernizimit dhe përmirësimit të saj, kjo në shumë fusha të tjera të kurikulës sonë, sidomos në drejtim të atyre për të cilat shoqëria, zhvillimet dhe transformimet e shpejta kanë kërkuar edhe ndërhyrje në kurikulën tonë arsimore, por një nga to në qëllimet tona prioritare është arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës.

Në këtë kuadër, gjej me vend që edhe edukimi ligjor duhet të jetë një pjesë e rëndësishme dhe e qenësishme e kurikulës sonë. Ndaj, ne, pas miratimit të modernizimit dhe përditësimit të kornizës kurikulare, jemi në procesin e hartimit të programeve të kurikulave bërthamë apo kurikulave me zgjedhje, të cilat do të kërkojnë tryeza diskutimi edhe me shumë partnerë dhe organizata të tjera, sidomos në fushën e edukimit ligjor, për ta përmirësuar dhe për ta bërë më të kapshme dhe më të prekshme nga të gjithë aktorët që ne kemi: nga nxënësit, nga mësuesit, nga prindërit, nga komuniteti që na rrethon, në bashkëpunim me të gjitha organizatat me të cilat ne ndërveprojmë. Në fakt, kemi shumë fusha dhe pika të përbashkëta, bashkëpunime dhe rezultate shumë të mira, të cilat kanë sjellë edhe frytet e veta, por, sigurisht, rastet që janë evidentuar si raste të dhunës, të krimit apo ngjarjet e fundit, tregojnë që edukimi ligjor ka ende vend për përmirësim. Pra, ende të gjithë këta aktorë nuk i njohin mirë të drejtat, liritë dhe deri ku shkojnë detyrat e tyre. Ndaj, e shikoj me vend që të kemi një bashkëpunim edhe më të frytshëm.

Faleminderit!

**Olta Aliaj** – Shumë faleminderit për sugjerimet tuaja!

Është lajm i mirë që po modernizohet kurikula dhe po bëhet një kornizë e re.

Dua të sjell në vëmendje që të jemi më eficientë me pjesën e minutazhit dhe më koncizë me komentet. Po.

**Elis Kuçi** - Për ekonomi tryeze, nuk fola pjesën e parë, por do të flas për edukimin ligjor dhe transparencën me publikun, meqenëse i kam më shumë përزمër dhe u kam kushtuar 12 vjet të jetës profesionale.

Unë jam Elis Kuçi dhe drejtoj zyrën e ankesave dhe të marrëdhënieve me publikun në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Nuk do të ndalem tek të dhënat zyrtare, shifrat, por dua të theksoj se që në ngritjen e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke qenë se fokusi kryesor janë ankesat dhe publiku, ne kemi ngritur një zyrë të përbërë nga katër nëpunës dhe dy ndihmës, pra gjashtë persona, me të cilët organizojmë çdo ditë pritje me qytetarët dhe me shtresa të ndryshme të shoqërisë. Dua të ndalem edhe te shtresat vulnerabël. Zyra jonë programoi të kishim një vend shumë të aksesueshëm edhe për shtresat vulnerabël, ndaj edhe në godinën e re është krijuar një zyrë ku të ketë akses çdo përfaqësues i këtyre shtresave, duke filluar nga të verbrit, nga ata që nuk kanë mundësi të lëvizin edhe me karrocën ndihmëse, që i përdorin personat me aftësi ndryshe. Ne kemi zhvilluar një plan komunikimi dhe informimi me qytetarët, e kemi miratuar prej vitit 2022, i cili është i pasur me takime jo vetëm në zyrë, por kemi dalë edhe në terren, siç e përmendi edhe moderatorja. Vitin që kaloi dhe këtë vit kemi zhvilluar tryeza edhe në rrethe, me shoqërinë civile, me nxënësit dhe studentët e Fakultetit të Drejtësisë, kryesisht edhe ata të Shkencave Sociale, duke qenë se fusha e drejtësisë është e lidhur edhe më shumë ...

Ne kemi në plan ta zhvillojmë. Me ndihmën e OSBE-së dhe me përfaqësuesin e tyre kemi qenë në dy qytete, Lushnjë dhe Lezhë, ku kemi zhvilluar takime shumë të frytshme me pjesëtarë të shoqërisë dhe të komuniteteve atje, takime të cilat do t'i shtrijmë edhe këtë vit në qytete të tjera, por kjo mbetet për t'u dakordësuar.

Dua të theksoj, duke menduar se ka një lloj rëndësie shumë të madhe, se, nisur nga fluksi i qytetarëve që kemi pritur dhe duke marrë edhe ankesat, është iniciuar një inspektim tematik pikërisht për zvarritjen e arsytimit të vendimeve në dy gjykata që kanë më shumë: në dhomën civile të Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, si dhe të Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative, sepse çështjet penale, nga vetë afatet e ngutshme ligjore, kanë më pak problematika në këtë drejtim.

Janë nxjerrë gjetjet përkatëse dhe janë lënë rekomandimet përkatëse. Ky është mendimi im personal, por nëse të gjitha institucionet e drejtësisë do të kishin një plan të përbashkët koordinimi për të zhvilluar një fushatë 3-5 vjet, sesa veç e veç, sado mirë që mund ta bëjë institucioni ynë apo edhe institucionet e tjera, përsëri një grup si arkitektura e sistemit të drejtësisë ka pak vështirësi në

kuptimin e njerëzve që nuk janë ende të familjarizuar ose nuk kanë njohuritë e duhura në fushën e drejtësisë. Kjo vlen, sepse shumica e njerëzve, në gjykimin tim, përballen në gjykatë edhe kur nuk kanë probleme për të shkuar në gjykatë. Pra, shkojnë bëjnë ankesa në gjykatë edhe kur janë ankesa që mund të zgjidhen shumë mirë në rrugë administrative ose nuk i ndjekin të gjitha hapat administrative dhe për rrjedhojë marrin edhe rrëzimin në gjykatë dhe kjo kthehet në një rreth vicioz.

Pavarësisht se ndihmat juridike ne i kemi adresuar shpesh dhe ankuesit kanë bërë një punë voluminoze, përsëri mendoj se ende ka vend që edukimi qytetar të jetë në fokus dhe bërja në grup do të ishte akoma më mirë, sepse gjithsecili për pjesën e vet do të kishte bërë një pasqyrë shumë më të mirë. Ne nuk mund të bëjmë vetëm një fushatë kur ai të pyet, për shembull, për administratën gjyqësore, që është kompetencë e një institucioni tjetër, që t'i mund t'i japësh vetëm një lloj njohurie bazike, por njohuri për problematikat që ata hasin në përditshmëri t'i nuk ia jep dot, për shkak se edhe fusha e punës nuk është ...

Besoj u përmblodha dhe shpresoj që me kaq pak të ketë dalë ideja që doja të nxirrja.

Faleminderit!

**Nadia Rusi** - Thelbi ishte te bashkimi i *puzzle*-t.

**Olta Aliaj** – Faleminderit!

Do t'ua jap fjalën zonjave këtu.

**Elona Meço** - Përshëndetje!

Unë quhem Elona Meço, gazetare, dhe prej rreth 25 vjetësh mbuloj kryesisht çështjet politike, por puna më ka bërë që të mbuloj gjatë gjithë kohës edhe Komisionin e Ligjeve, kështu që kam edhe një interes personal për çështjen e ligjeve. Gjithashtu, kam mbuluar shumë gjatë edhe komisionin që zoti Xhafaj ka drejtuar për reformën në drejtësi, ndaj disa probleme i njoh.

Unë ju dëgjova juve kur folët edhe në pjesën e parë për çështjen e aksesit në drejtësi apo çështjen e një procesi të drejtë ligjor dhe tani edhe për edukimin ligjor. Nëse ne do të rrimë këtu, në këtë tryezë ku jemi mbledhur, askush nuk e merr vesh se çfarë ne po bëjmë, askush nuk i di përpjekjet tuaja. Kështu që, për mendimin tim, gjëja e parë që ne duhet të bëjmë për të informuar njerëzit, për t'i edukuar, për t'u dhënë atyre një edukim ligjor, është informimi. Sa më shumë ata të dinë, jo vetëm për çështjet ligjore, aspektin ligjor, por se ku ta kërkojnë këtë ndihmë, ku të kontrollojnë, ku duhet të drejtohen që të marrin një informacion, aq më mirë është.

Unë besoj se edukimi ligjor është një fjalë e madhe për aspektin e Shqipërisë, por edhe për shumë vende të zhvilluara. Unë pashë mbrëmë një studim ku thuhej se në Mbretërinë e Bashkuar vetëm 2/3-tat e njerëzve mendonin se kishin një edukim ligjor, nuk dinin se kishin një edukim ligjor vetëm 1/3-ta, që përkonte me një studim që ishte bërë këtu.

Por çështja është edhe e financimit. Ju përmendët që buxheti i Ministrisë së Drejtësisë ka vetëm 1%, që është një shifër e tmerrshme për mendimin tim, skandaloze, që njerëzit të njihen me aspektet ligjore të përditshmërisë së tyre. Për mendimin tim, e para nis nga buxheti, e dyta nis nga informimi, sepse për t'u informuar do të duhen disa përpjekje, disa ekspertë, disa specialistë, që njerëzit të njihen dhe të kenë të paktën disa baza të edukimit ligjor.

Duke qenë se ne nuk e kemi këtë eksperiencë, as edukimin ligjor, kemi shumë pak të dhëna apo eksperiencë për edukimin financiar, edukimin sportiv, kemi shumë mangësi, duhet bërë shumë në informim dhe secili nga ne, çdo institucion, çdo organizatë, ka rrjetet e veta sociale. Pse të mos i përdorim ato? Ato edhe kushtojnë pak. Për shembull, gjithçka që ju bëni mund ta nxirrni në rrjetet sociale, me disa formate të vogla të dhura, që ne të mund të marrim informacion. Unë kam një shprehje: kur nuk e di unë, të tjerët nuk e dinë.

Nga ato që ju folët sot unë di shumë pak. Kështu që, njerëzit besojnë se dinë pak ose aspak. Pra, informimi është shumë gjë e mirë dhe duke informuar qytetarët ne i fuqizojmë ata. Një qytetar i fuqizuar, besoj unë, i ndihmon edhe një sistemi të fuqizuar.

Ju falënderoj!

**Olta Aliaj** - Po.

**Serona Kolaveri** - Shkurtimisht, nëse i referohemi informimit dhe edukimit ligjor të qytetarëve, veçanërisht për pjesën e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, nëse i referohemi progresraportit të Komisionit European, përpos kuadrit ligjor gjithëpërfshirës, vlerësohet fakti që ndihma juridike falas ka ardhur në rritje. Fakti që ka ardhur në rritje në drejtim statistikash, tregon që edhe informimi ka ardhur duke u rritur. Pa dyshim që nevojat janë të mëdha, sidomos në rajonet më të largëta, që nuk mbulohen me qendra apo ofrues të shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas i ka dhënë një fokus të veçantë informimit ligjor të publikut dhe në kalendarin vjetor që ne planifikojmë jemi ndalur në dy komponentë: në fushatat ndërgjegjësuere në rajonet më të vogla dhe në fushatat ndërgjegjësuere, të cilat kanë në fokus kategoritë e veçanta përfituese të ligjit, si viktimat e dhunës në familje, të miturit në konflikt me ligjin, e të tjera.

Në vitin 2024, siç u shpreh edhe zonja, ne kemi qenë në terren: në Krujë, Belsh, Libohovë, Bulqizë, Mirditë, Mallakastër, Kuçovë, si dhe kemi ende bashki të vogla për të realizuar sesione informuese, por duke pasur në fokus bashkëpunimin me bashkitë e vogla, në kuadër të krijimit të kontakteve, urave lidhëse, për referimin e rasteve te qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore që ndodhen në qytetet më të mëdha.

Kemi lidhur marrëveshje bashkëpunimi dhe shpresojmë që për vitin 2025 këto marrëveshje të bëhen efektive dhe të kemi një rritje të numrit të rasteve të trajtuara edhe në zonat më të largëta.

Nëse i referohem gjetjeve të analizës për sa u përket klinikave të ligjit, është e vërtetë që referuar ligjit për ndihmën juridike, klinikat e ligjit janë ofrueset e shërbimit të ndihmës juridike parësore, por nga ana tjetër këto të fundit janë në varësi të institucioneve të arsimit të lartë. Kjo do të thotë që edhe mekanizmat buxhetore, mbështetja buxhetore, është në varësi të drejtpërdrejtë të institucioneve të arsimit të lartë, por edhe të Ministrisë së Arsimit nëpërmjet agjencive për kërkimin shkencor, për inovacionin, të cilat i mbështesin institucionet e arsimit të lartë. Ne jemi të angazhuar, me aq sa përcakton edhe brendësia e ligjit tonë në kuadër të trajnimit të studentëve dhe informimit të tyre, që është e lidhur pazgjidhshmërisht edhe me pjesën e edukimit ligjor të publikut.

Nëse u referohem të dhënave vetëm për vitin 2024, janë zhvilluar 427 takime dhe aktivitete ndërgjegjësuere nga institucioni, por edhe nga ofruesit e shërbimit në rrethe. Pa dyshim që janë pak. Ekziston nevoja për zhvillimin e më shumë aktiviteteve.

Gjithashtu, nëse i referohemi fjalës së zonjës Meço, pjesa e informimit në rrjete sociale dhe medie ka qenë fokusi ynë, por duhet të vendosim theksin që kategoritë përfituese nga ligji “Për ndihmë juridike” jo shpeshherë e kanë mundësinë dhe qasjen për të aksesuar internetin dhe rrjetet sociale. Ndaj, mendoj se pjesa e ndërgjegjësimit duhet të jetë më shumë në medien vizive, në televizione. Pra, edhe televizionet lokale dhe kombëtare duhet të kenë një qasje më proaktive ndaj institucioneve shtetërore, në kuadër të promovimit të këtyre shërbimeve, që janë falas për qytetarët, në mënyrë që edhe qytetarët të kenë një rritje të informimit.

Do të ndalem pak shkurt edhe te pjesa e ndërmjetësimit, që u has pak më përpara. Kemi pasur një bashkëpunim të ngushtë me Dhomën Kombëtare të Ndërmjetësve, në kuadër të një projekti, ku ofrimi i shërbimit të ndërmjetësimit është ofruar falas nga ana e Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve pas referimit të rasteve nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore.

Për t’u marrë në konsideratë si propozim në të ardhmen, përfshirja e ndërmjetësimit falas si pjesë e sistemit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti besoj se do të kishte një impakt mjaft

pozitiv edhe në kuadër të uljes së ngarkesës së gjyqësorit, duke marrë për bazë edhe praktikën e vendeve europiane. Pra, ofrimi i këtyre shërbimeve jo vetëm parësore, dytësore, pra përfaqësim ligjor në gjykatë, por duke shkuar edhe më tej në ndërmjetësim ligjor falas, besoj se do të kishte impaktin e tij pozitiv për qytetarët në nevojë.

**Olta Aliaj** - Faleminderit!

Për shkak të kohës, do të kemi vetëm dy ndërhyrje të fundit.

Fjalën e ka përfaqësuesja e AKSHI-t.

**AKSHI** – Faleminderit!

Ju e përmendët shpesh fokusin për sa u përket grupeve vulnerabël, por edhe personave me aftësi të kufizuara. Unë dua t’ju jap një informacion për sa i përket angazhimit që AKSHI ka ndërmarrë dhe po realizon për të mundësuar ofrimin e shërbimeve në mënyrë të barabartë edhe për personat me aftësi të kufizuara. Ne jemi duke punuar në dy drejtime. Së pari, kemi hartuar një projektvendim që do të detyrojë institucionet publike për aplikimin e standardeve të aksesueshmërisë në faqet e tyre të internetit. Këtu përfshihet edhe baza ligjore apo mund të ketë module për edukimin e publikut. Pra, kjo është e gjithë pjesa e kontetit.

Për sa i përket të drejtës së tyre për përfitimin e shërbimeve publike, që, siç ju e dini, është portali “*e-Albania*”, ku ofrohen 95% e shërbimeve publike *online*, edhe atje do të kemi përmirësime teknike. Ne jemi duke realizuar përmirësimin “*e-Albania*”-s dhe portali do të përshtatet për t’u aksesuar nga personat me aftësi të kufizuara. Ju e dini që në portalin “*e-Albania*”, përpos marrjes së shërbimeve, ka edhe një informacion shumë të gjerë për sa i përket bazës ligjore të çdo shërbimi publik, të drejtave apo të gjitha informacioneve në lidhje me kohëzgjatjen dhe procedurat ligjore për ofrimin e shërbimeve. Pra, shkurtimisht këto janë dy ndërhyrjet që ne jemi duke realizuar edhe teknikisht, por edhe në kuadrin ligjor.

Faleminderit!

**Olta Aliaj** – E fundit.

**E ftuar** - Shumë shkurt, si përfaqësuese e një klinike ligjore universitare dhe problemeve konkrete që ne hasim, e para, problemi i informimit dhe përçimit të informimit në këto shtresa vulnerabël, apo të marginalizuara, për mendimin tonë është problemi më madhor. Mendoj se informimi nëpërmjet rrjeteve sociale apo televizioneve në këtë rast është i vështirë, sepse janë shtresa të tilla që kanë vështirësi në akses në këto mjete. Kështu që, duhet gjetur mekanizmat e duhur për të përçarur këtë lloj informacioni dhe kjo do të ishte mirë nëse do të ishte në terren.

Kjo pasjellë edhe një problem tjetër, në vlerësimin tonë dhe eksperiencën tonë 5-6 vjeçare në këtë drejtim, që është edhe një lloj difidence e këtyre personave për t'iu drejtuar dhe për të marrë ndihmë ligjore falas, për shkak se është krijuar një lloj mendësie që ndihma ligjore pa pagesë nuk është e të njëjtës cilësi me atë me pagesë.

Kështu që, duke përçuar informacionin aty ku duhet dhe ashtu siç duhet, në forma konkrete dhe të prekshme për këto kategori, do të kishte shumë impakt dhe shumë ndryshim.

E dyta, pse jo klinikat ligjore të mos japin një kontribut të tyrin në edukimin ligjor. Pra, e shikoj shumë të domosdoshme futjen e pjesës së kurikulës në shkolla, por ama dhënia e këtij informacioni, dhënia e një edukimi ligjor nga studentë të universiteteve të drejtësisë të vitit të pestë, pjesë e klinikave ligjore, në këto shkolla, për mendimin tim do të ishte një ide shumë e mirë për të formuar breza me njohuri më të thella dhe më të mira në pjesën ligjore.

Faleminderit!

**Olta Aliaj** – Faleminderit!

Ndjesë, por për shkak të kohës, na duhet ta mbyllim këtë panel.

*(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Po, patjetër. Fjalën e ka zoti Toni Gogu për fjalën përmbyllëse.

**Toni Gogu** – E nderuar zonja Aliaj,

Të nderuar panelistë,

Shumë të respektuar pjesëmarrës, përfaqësues të shoqërisë civile, të botës akademike, të institucioneve shtetërore, të organizmave ndërkombëtare, unë dua t'ju falënderoj thellësisht për diskutimin e sotëm! Besoj se ishte një diskutim shumë i singertë, besoj se çdo ndërhyrje, megjithëse unë personalisht disa i kam veçuar, ishte e çmuara, besoj se sot modeluam përmes këtij dialogu, qoftë edhe për dy orë, një Shqipëri më transparente, më dialoguese dhe besoj se kemi ndihmuar sado pak në forcimin e themeleve demokratike të vendit tonë. Pra, ju sot, me diskutimin tuaj, keni pushtuar një nga sallat kryesore të Parlamentit të Shqipërisë, duke vlerësuar jo vetëm ecurinë e reformës në drejtësi, por edhe realitetin e vendit tonë për sa u përket dy të drejtave themelore, që u veçuan për këtë tryezë, por që në dokumentin analitik ka më shumë që janë analizuar dhe pas ndërhyrjeve tuaja besoj se do të ketë edhe disa të tjera, që do të thellohen.

Pra, jam shumë mirënjohës, sepse udhëtimi nisi me zërat e ekspertëve, por sot u bashkuan edhe zërat tuaja. Unë besoj se është bërë një kor shumë i madh dhe jam i sigurt që pas nxitjes së zonjës Meço, që e vlerësoj shumë, zërat e shoqërisë shqiptare do të shtohen, për shkak se kjo është

e mira jonë e përbashkët, që kjo shoqëri të forcohet jo vetëm në këto dy aspekte, por në të gjitha aspektet e të drejtave të njeriut.

Vlerësova shumë në pjesën e parë të procesit të rregullt ligjor, që megjithëse në vitet që kanë shkuar, të paktën në 6-7 vjetët që kanë shkuar, vetë magistratët u futën në sprovën e madhe të një procesi të rregullt ligjor, që ishte vetingu, ju përsëri çmuat se vërejtjet, vlerësimet, analizat tuaja, përsëri t'i bëni për atë pjesën e Shqipërisë dhe të shqiptarëve që nuk duket. Pra, diskutimet tuaja për qasjen në sistemin e drejtësisë të shtresave vulnerabël për mua janë shumë inkurajuese, se si ne atje duhet të thellohemi më shumë, se si ne atje duhet të bëjmë më shumë. Pra, vlerësoj ndërhyrjet e koleges nga *"Save the Children"* për pjesën e fëmijëve!

Falënderoj shumë përfaqësuesen e ambasadës suedeze, sepse unë kam qenë dëshmitar se si ju na keni ndihmuar, ne, Shqipërinë, për të ndërtuar një proces ndërsektorial, duke filluar nga policia, te prokuroria, te gjykatat, te psikologët, te qendrat komunitare, tek e gjithë shoqëria, se si të mundemi t'u gjendemi fëmijëve në konflikt me ligjin dhe se si duhet të vazhdojmë dhe të kemi atë vëmendje!

Natyrisht, pjesa e dytë, edukimi ligjor, është gjithashtu shumë interesante. E kuptoj që koha na ka vendosur në një këmishë force, që ne nuk e heqim dot, por dua ta mbyll duke kujtuar shprehjen, që jam i bindur se shumë nga ju e kanë dëgjuar: "Nëse do të ecësh shpejt, ecë vetëm, por nëse do të ecësh larg, ecë bashkë me të tjerët". E di që kemi pasur kritika për procesin, i dëgjoj dhe jam shumë i vetëdijshëm për to, bashkë me kryetarin e komisionit, që e vlerësoj, se sot ka qenë gjatë gjithë kohës këtu, zotin Xhafaj, dhe kolegun Shalsi, që erdhi në fillim, por pastaj iu desh të largohet, sepse ne jemi duke diskutuar buxhetin në Kuvend.

Procesi që ka nisur Kuvendi për të thelluar reformat e vendit tonë mund të ketë defekte, por një gjë është e sigurt, që ky proces është i hapur. Mund të ketë defekte, por është i hapur. Do të thotë që në këtë moment ne u takuam së bashku në këtë tryezë. Jam i bindur, që jo vetëm ekspertët që kanë përgatitur dokumentin analitik, por edhe ne, shërbimet e Kuvendit, do të marrim secilën ndërhyrje dhe secilën ide për ta bërë pjesë të procesit dhe kur të rishikohet dokumenti, pa diskutim që ju do të keni edhe fjalën e fundit, qoftë për pjesën të drejtave të grupeve vulnerabël, qoftë për pjesën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, qoftë edhe për pjesë të tjera të strategjia e edukimit, pra rrjeti që ne si Kuvend nuk kemi bërë punën e duhur. Pra, nëse kishte një gjë sot që e vlerësova pa masë, ishte të folurit troç dhe do të falënderoja në mënyrë të veçantë gazetaren Hoxha, që e solli terrenin dhe procesin ligjor ashtu siç ajo e ka ndeshur në sallonet e gjykatave!

Në fund fare, duke falënderuar të gjithë ekspertët dhe të gjithë ju që sot pasuruat atë dokument me ide dhe me disa pjesë që duhen shtjelluar edhe më shumë, unë do të doja ta mbyllnim këtë paradite dhe t'ju uroj një pjesë tjetër të ditës të frytshme dhe plot sukses, ashtu siç ju e meritoni!

Faleminderit!

**Olta Aliaj** – Faleminderit, zoti Gogu!

Zoti Xhafaj, si kryetar i komisionit, doni të thoni ndonjë gjë? Jo. Dakord, e mbyllim. Faleminderit të gjithëve për sugjerimet dhe ju uroj një ditë të mbarë!

## **MBYLLET MBLEDHJA**

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve**  
**Euzheni Pengili**

**Koordinator i Komisionit**